



PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE URBANE PER BASHKINE LIBRAZH'D

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Bashkinë Librazhd

Ky studim është përgatitur nga Bashkia Librazhd me mbeshtetjen nw pwrlllogaritjene kosos nga
“Bashki të Forta” përgjatë periudhës **tetor – dhjetor 2024**.

Janar 2025

Përmbajtja:

I.	HYRJE	7
1.1	Cfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane?	7
1.2	Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet.....	7
1.3	Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit	8
1.4	Hapat baze të planifikimit	8
II.	KUADRI LIGJOR, POLITIKAT KOMBETARE DHE ATO RAJONALE.....	10
2.1	Përmbajtja e legjislacionit shqiptar	10
2.2	Politikat kombëtare	12
2.3	Politikat sipas planit rajonal.....	12
III.	PERSHKRIMI I SITUATES SË PËRGJITHSHME	14
3.1	Profili i Bashkisë Librazhd	14
3.1.1	Pozita gjeografike	14
3.1.2	Hidrografia.....	15
3.1.3	Burimet natyrore, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës	16
3.1.4	Demografia	16
3.1.5	Popullsia aktive dhe papunësia	19
3.1.6	Bizneset.....	19
3.1.7	Rrjeti rrugor	21
3.2	Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve.....	22
3.2.1	Organizimi në nivel qendror	22
3.2.2	Organizimi në nivel rajonal.....	23
3.2.3	Organizimi në nivel lokal.....	23
3.2.4	Struktura e Bashkisë për mbetjet	24
3.2.5	Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet	25
3.3	Menaxhimi i Mbetjeve	26

3.3.1 Analiza e mbetjeve.....	27
3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane	28
3.3.3 Fshirja e rrugeve dhe trotuareve.....	33
3.3.4 Depozitimi.....	33
3.3.5 Riciklimi	34
IV. Ekonomia dhe Financimi	36
4.1 Buxheti vjetor dhe investimet	36
4.2 Ndarja e kostove	37
4.3 Tarifat dhe realizimi i te ardhurave.....	40
4.4 Mbulimi i koston së shërbimit.....	45
4.5 Indikatorët e performancës së shërbimit të ofruar.....	47
V. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE.....	49
5.1 Objekti i Planit	50
5.1.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit	50
5.1.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit.....	50
5.2 Skenarët e administrimit të mbetjeve.....	53
5.2.1 Skenari i riciklimit të mbetjeve	53
5.2.2 Skenari i grumbullimit miks të mbetjeve	55
5.2.3 Buxhetimi në bazë aktiviteti	59
VI.PERSPEKTIVA FINANCIARE.....	77
7.1. Çështja e financimit dhe strategjia e “mbulimit të koston”	77
VII.KUADRI LIGJOR DHE INSTUTUCIONAL	84
7.1 RREGULLORJA VENDORE	84
7.2 Detyrimi dhe Sanksionet.....	85
7.3 Liçensimi Mjedisor	87

7.4 Pjesmarrja e Sektorit Privat.....	87
7.5 Mbështetja Politike	88
VIII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	90
IX. Plani i Aktiviteteve	93
X. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	97
Detyrat e ekipit monitorues.....	99

Lista e Tabelave, Figurave dhe Grafikëve

- Tabela 1. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet*
- Tabela 2: Fshatrat në përbërje të NJA*
- Tabela 3. Popullsia në Bashkinë Librazhd*
- Tabela 4. Numri i familjeve me ndihme ekonomike dhe aftësia e kufizuar*
- Tabela 5. Shperndarja e bizneseve ne njesite administrative*
- Tabela 6: Te dhena per rruget, gjendja ekzistuese per Bashkinë*
- Tabela 7: Popullsia e mbuluar me shërbim*
- Tabela 8: Distanca që përshkruan makina teknologjike*
- Tabela 9: Shperndarja e bizneseve ne njesite administrative*
- Tabela 10: Shpërndarja e kontenierëve*
- Tabela 11: Sasia e mbetjeve që gjenerohen*
- Tabela 12: Sipërfaqe rrugë, trotuare dhe sheshe*
- Tabela 13: Shpenzimet e planifikuara per rehabilitimin e venddepozitimit*
- Tabela 14: Treguesit kryesorë të shërbimit të pastrimit*
- Tabela 15: Ndarja e fondeve sipas sektoreve te bashkise*
- Tabela 16: Buxheti i vitit 2024 dhe 2025 me peshën specifike për mbetjet*
- Tabela 17: Shpenzimet e kontratave të shërbimit*
- Tabela 18: Shpenzimet e kontrates bazë*
- Tabela 19: Shpenzimet e kontrates shitesë*
- Tabela 20: Shpenzimet e kontratës bazë dhe shitesë*
- Tabela 21: Tarifa e pastrimit për bizneset*
- Tabela 22: Tarifa e pastrimit për familjarët*
- Tabela 23: Treguesit e realizuar sipas kategorive*
- Tabela 24: Mbulimi i koston operative nga të ardhurat*
- Tabela 25: Indikatorët e performancës*
- Tabela 26: Sasia e mbetjeve qe shmangen nga incerimi nepermjet riciklimit*
- Tabela 27: Kosto qe kursehet nga skenari i riciklimit te mbetjeve*
- Tabela 28: Dendësia e PGM-ve*
- Tabela 29: Ilogaritjes së kontenjerëve sipas frekuencës së shërbimit dhe mbetjeve të gjeneruara*
- Tabela 30: Numri i nevojshem i kontenierëve per vitet 2025-2029*
- Tabela 31: Sasia e mbetjeve që gjenerohen në ditë dhe në vit*
- Tabela 32: Kosto e fshirjes së rrugëve*
- Tabela 33: Kosto e lagies së rrugëve*
- Tabela 34. Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh 2025*
- Tabela 36: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*
- Tabela 37: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*
- Tabela 38. Parashikimi i mirembajtjes kamionit në 5 vitet e ardhshme*
- Tabela 39: Kosto e mirëmbajtjes*
- Tabela 40. Kosto e grumbullimit të mbetjeve*
- Tabela 41. Kosto e transportit të mbetjeve*
- Tabela 42. Kosto e shoferëve dhe operatorëve*
- Tabela 43: Kosto e amortizimit sipas 3 zonave të mbetjeve*
- Tabela 44. Kosto e totale e shërbimit 2025*
- Tabela 45. Struktura e koston së shërbimit:*
- Tabela 46: Kosto e totale e shërbimit*
- Tabela 47: Kosto totale e investimeve në vite*
- Tabela 48 Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2025-2029*

Tabela 49: Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave

Tabela 50: Plani i Veprimit

Tabela 51: Mardhënia raportuese ne nivel vendor dhe kombëtar

Tabela 52: Skema e monitorimit të shërbimit të pastrimit

Figura 1: Territori i Bashkisë Librazhd

Figura 2: Harta e hidrografisë

Figura 3: Dendësia e popullsisë

Figura 4: Rrjeti infrastrukturës sipas kategorive

Figura 5: Skema e organizimit institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor

Figura 6: Organograma e Bashkisë Librazhd

Figura 7: Mbulimi i shërbimit të mbetjeve Bashkia Librazhd

Figura 8: Fluksi i Mbetjeve

Figura 8: Shpërndarja e kontenierëve

Figura 9: Shpërndarja e kontenierëve pjesore sipas NJA

Figura 10: Venddepozitimi “Rrypezat e Lushit”

Figura 11: Kosha per ndarjen e mbetjeve

Figura 12: Zonimi ishërbimit

Figura 13: Skema ideale e mbledhjes së mbetjeve

Figura 14: Skema e menaxhimit miks te mbetjeve

Figura 15: Struktura e koston operacionale 2025

Grafiku 1: Shpërndarja e popullsisë 2017-2019

Grafiku 2. Shpërndarja e bizneseve ne njesite administrative

Grafiku 3: Niveli i pagesës sipas kategorive

Grafiku 4: Niveli i pagesës sipas kategorive

Grafiku 5: Numri i kontenjerëve sipas viteve 2025-2029

Grafiku 6: Ndryshimet në koston e shërbimeve në vitet 2025-2029

Grafiku 7: Pesha specifike e tarifës së pastrimit 2025-2029

I. HYRJE

1.1 Cfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane?

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (**PVMMNU**) është një dokument planifikimi strategjik, që mundëson zbatimin e politikës kombëtare për mbetjet në nivel vendor. Një PVMMNU tregon një drejtim për të ardhmen dhe nxit mendimin e përbashkët mes shumë aktorësh të ndryshëm, që janë përfshirë në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit etj. PVMMNU përputhet me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve dhe objektivat e saj, duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare, përshkruan karakteristikat e zonës dhe mbetjet duke dhënë një përshkrim të rrymës së mbetjeve dhe përgjegjësive për to, vëllimin e mbetjeve që duhet të administrohen, bën një vlerësim të skemave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, paraqet alternativa të menaxhimit të mbetjeve, rekomandon masa dhe instrumentet për përmirësimin e komponentëve të menaxhimit të mbetjeve.

Që nga viti 1994, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve si dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve vendore, duke i bërë plotësisht përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Procesi i delegimit të kompetencave, pavarësisht përmirësimeve graduale të verejtura është kthyer në një sfidë për autoritetet vendore, duke i ballafaquar me mungesën e instrumenteve të nevojshme për menaxhimin mjedisor të mbetjeve, mungesën e teknologjive dhe të investimeve si dhe të kapaciteteve të mjaftueshme të burimeve njerëzore dhe financiare.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve është miratuar në vitin 2011 sipas VKM – së Nr.175, datë 19.01.2011, i cili duhet të pasohet nga hartimi i 12 planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe më pas do vijonte hartimi i planeve vendore për menaxhimin e mbetjeve nga cdo autoritet vendor.

1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”.

Bashkia Librazhd tashmë përfshin një territor të zgjeruar me zonën urbane dhe rurale dhe mungesë të shërbimit në të gjithë territorin. Deri më sot është realizuar vetëm grumbullimi miks i mbetjeve të ngurta urbane dhe transportimi i tyre drejt vendit të grumbullimit dhe mungojnë nismat dhe politikat vendore, për të zvogëluar dhe diferencuar sasinë e mbetjeve në burim.

Në përgjithësi, problematika në sektorin e mbetjeve lidhet ngushtë me mungesën e instrumenteve të duhura për menaxhimin mjedisor të tyre, mungesën e teknologjive dhe investimeve dhe kapacitetet e pamjaftueshme në burimet njerëzore dhe financiare.

1.3 Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit

Politika kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, përfshin edhe detyrimin ligjor për hartimin e një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane, (SKMM, PKMM, neni 12 i ligjit 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”), që çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve¹; (neni 4 i ligjit 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”), ku mbrojtja e mjedisit nga ndotja përbën përparësi dhe është e detyrueshme edhe nga bashkia².

Hartimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve³, planit rajonal dhe lokal është një detyrim, që rrjedh nga direktivat e Këshillit të Evropës që Shqipëria duhet të zbatojë si një vend potencial për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian⁴.

1.4 Hapat baze të planifikimit

PVMMNU në tërësinë e tij është një proces i vazhdueshëm që funksionon me cikël dhe përbehet nga nën procese të tilla si: planifikimi, zbatimi, dhe rishikimi i planit. Planin duhet të rishikohet rregullisht të paktën një herë në 5 vjet, megjithatë në rast se ka zhvillime të rëndësishme në sektorin e mbetjeve, një proces për rishikimin e planit mund të përshpejtohet. Rishikimi i planit përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe masave, që lidhen me përmbushjen e tyre, duke ndjekur të gjithë ciklin e plotë të planifikimit.

Hapi i parë është krijimi i strukturave organizative. Në këtë fazë përcaktohen aktorët kryesorë që duhen përfshirë në procesin e planifikimit, palët e interesuara që do ndikohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga plani i ardhshëm i menaxhimit të mbetjeve. Kjo fazë përmban një numër aktivitete kryesore të projektuara për të përcaktuar vijimësinë e procesit të planifikimit. Disa nga aktivitetet kryesore janë:

Mobilizimi, konsultimet paraprake, përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi organizative, analiza e grupeve të interesit dhe ekspertiza e jashtme.

Hapi i dytë është vlerësimi i gjendjes ekzistuese. Qëllimi i këtij plani është të ofrojë një pamje të përgjithshme dhe të hollësishme të kontekstit vendor për menaxhimin e mbetjeve, nëpërmjet mjeteve të informacionit dhe vlerësimin e aspekteve të ndryshme të saj. Për hartimin e planit është e rëndësishme të kemi një panoramë të qartë të zonës së mbetjeve dhe të grupeve të konsumatorëve. Profilizimi i konsumatorëve dhe zonës së mbetjeve nënkupton mbledhjen e informacionit të nevojshëm për familjet, njësitë tregtare, industrinë dhe institucionet, të cilët janë

¹ Bashkia përgatit planin vendor të menaxhimit të mbetjeve konform kërkesave të nenit 10 të ligjit 10463/2011.

² Sipas nenit 11 të ligjit 10431/2011, Bashkia brenda kompetencave të saj, harton planin përmes bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

³ Miratuar: VKM nr.175, datë 19.1.2011

⁴ Në qershor 2006 është firmosur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe rrjedhimisht Qeveria Shqiptare ka marrë një seri angazhimesh që janë përqendruar në arritjen e pranimit në BE.

klientë për një periudhë kohe të përkohshme ose të përhershme kohore, karakteristikat urbane, të tilla si tipologjia, infrastruktura, burimet natyrore, elementët social ekonomike dhe mjedisore.

Hapi i tretë, planifikimi operacional i menaxhimit të mbetjeve. Procesi i planifikimit organizohet në bazë të kërkesave që rrjedhin nga analizimi i gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve dhe supozimet përkatëse për projektimin e zhvillimeve të ardhshme në këtë sektor. Kjo fazë përfshin përcaktimin e objektivave, identifikim dhe vlerësimin e procedurave, metodologjive dhe investimeve, të cilat bëjnë të mundur arritjen e këtyre objektivave. Planifikimi është një proces ku përcaktohen paraprakisht se çfarë duhet të kryhet dhe përmbushur, deri kur, nga kush, si dhe me çfarë kostoje si dhe alternativat teknike dhe ekonomike.

Hapi i katërt është planifikimi financiar i menaxhimit të mbetjeve. Pasi NjQV-të kanë zhvilluar një metodologji për organizimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, është e nevojshme të marrin në konsideratë financimin e këtyre shërbimeve, cilat janë kostot e investimeve si dhe kostot operationale. Planifikimi financiar është i domosdoshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e zbatimit që në fillim. Analiza e përballueshmërisë së sistemit është e domosdoshme të vlerësohet nga vetë bashkia.

Hapi i pestë është zbatimi i planit. Kjo fazë parashikon masat, aktivitetet, aktorët përgjegjës dhe koha kur duhen kryer. Plani i Veprimit duhet të përcaktojë qartësisht tre elementet e mëposhtëm:

1. Listën e veprimeve
2. Personat përgjegjës për veprimin
3. Kohën e përmbushjes së veprimeve.

Bashkia është përgjegjëse drejtpërdrejt për zbatimin e planit në terren nëpërmjet drejtorive të saj, të tilla si drejtoria e menaxhimit të mbetjeve, ndërmarrja e pastrimit, drejtoritë e financës si dhe strukturat e monitorimit dhe zbatimit në terren.

Hapi i gjashtë është rishikimi i planit. Monitorimi i planit duhet të jetë një proces vlerësimi i vazhdueshëm dhe periodik, që kërkon rishikimin e objektivave dhe masave apo veprimeve përkatëse. Vlerësimi i planit duhet të parashikojë hapat pasues të mëtejshëm, treguesit dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse janë përmbushur objektivat, dhe për të raportuar tek vendimarrësit.

II. KUADRI LIGJOR, POLITIKAT KOMBETARE DHE ATO RAJONALE

2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfilleve sipas standardeve të BE-së, sigurimi i lehtësive për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve adapton shumicën e direktivave, vendimet dhe rregulloret e BE-së, dhe parashikon prioritetet dhe hierarkinë për menaxhimin e mbetjeve që paraprihet nga: (1) parandalimi; (2) ripërdorim; (3) riciklimi; dhe (4) alternativa të tjera, si burim energjie; dhe (5) asgjësimin përfundimtar".

Ligji përcakton njëherazi dhe hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera pushteti vendor duhet të hartojë, miratojë dhe zbatojë PVMM.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plotësohet me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili në nenin 23, përcakton që mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, është tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkisë.

Ligji për koncesionet dhe PPP 125/2013 i miratuar nga Parlamenti më 25/04/2013, lehtëson njësitë e qeverisjes vendore në përfshirjen e kapitalit privat përmes zhvillimit të programeve të PPP.

Më poshtë pasqyrohet përmbledhja ligjore në fushën e mbetjeve:

Ligjet kryesore në fushën e mbetjeve	Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar me ligjin nr.156, datë 10.1 2013.
	Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbetjeve".
	Ligji nr. 9537, datë. 18.5.2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", i azhurnuar me ligjin nr.9890, datë 20.03.2008.
	VKM 117/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM 175/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të

Ligjet dytësore në fushën e mbetjeve	mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”
	VKM 418/2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”
	VKM 798/2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”
	VKM 641/2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte”
	VKM nr.687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.
	VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
	VKM nr.608, datë 17.09.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.
	VKM Nr. 866 datë 04.12. 2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.
	VKM Nr. 705 datë 10.10. 2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”
	VKM nr. 452, datë 11.7.2012 “Për landfillet e mbetjeve”
	VKM Nr. 178, datë 06.03.2012 “Për Incinerimin e mbetjeve”
	VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për amballazhet dhe mbetjet e tyre, ndryshuar me vkm nr.52, date 5.2.2014”.
	VKM Nr. 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”
	VKM nr. 333 datë 26.01.2011 “Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”.
	Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet, nga krijimi, transporti dhe deri tek trajtimi përfundimtar”
	Rregullore nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
	Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 “Për aprovimin e rregullave, përmbatjes dhe afatave për skicimin e planeve për menaxhimin e mbetjeve”
Akte të tjera	Ligji nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
	Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncensionet”, të ndryshuar me ligjin

ligjore që lidhen direkt apo indirekt edhe me menaxhimin e mbetjeve	10157, date 15.10.2009
	Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
	VKM nr.247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
	Vendimi nr. 103, datë 31.03.2002 “Në lidhje me monitorimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë”
	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
	Ligji nr.10081, datë 23.02.2009 “Mbi licensimin, autorizimin dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela 1: Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet

2.2 Politikat kombëtare

Strategjia dhe Plani Kombëtar 2011 – 2017 përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Këto dokumente janë në proces rishikimi dhe rikonceptimi që ka nisur në vitin 2017 dhe mbulon periudhën 2018 – 2033.

Draft Strategjia Shqiptare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit (2018) ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të rivlerësojë aftësitë e vendit për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE dhe specifikisht *acquis communautaire* të mishëruara në Kapitullin 27 për mjedisin. Ky dokument do të përshtasë drejtimet strategjike për ti bërë ato me efikase dhe të realizueshme për zbatuesit e politikave të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Objektivat specifike të strategjisë janë:

- Përmbushja e detyrimeve specifike të *acquis* të KE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Zbatimi i VKM që kanë të bëjnë me sektorin e mbetjeve.
- Adresimi i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat ballafaqohet vendi në një mënyrë të koordinuar dhe të integruar.

2.3 Politikat sipas planit rajonal

Ministri i Mjedisit ka nxjerrë udhëzimin “Për rregullat, përmbajtjen dhe afatet e aprovuara që janë përcaktuar për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, nr. 6, datë 27.11.2007. Sipas Udhëzimit, brenda një viti nga miratimi i Planit Kombëtar, duhet të hartohen planet rajonale në përputhje me parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar (neni 8). Po ashtu në bazë të ligjit të MIM (neni 13 i ligjit 10463/2011 të amenduar me 2013) qarku është institucioni

përgjegjës për aprovimin dhe ndjekjen e zbatimit të planit rajonal të MIM dhe atë planeve vendore, përmes dhe raportimeve që ky institucion bën në ministrinë përkatëse.

Planet rajonale përcaktojnë masat që duhen ndjekur nga autoritetet e qeverisë vendore për zbatimin e objektivave të PKMM të ngurta (neni 10).

Qarku i Elbasanit nuk ka ende një plan rajonal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake, pritet që në 2020 të nisë puna për hartimin e tij për zonën respektive të mbetjeve;

Ndërkohë objektivat e draft Strategjisë që lidhen me kompetencat në nivel rajonal dhe vendor janë:

- Afatshkurtra (2018-2023)
 - Zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake / vendore në 50% të NJA
 - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MMN rajonale me prioritet "Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve" (ZMM)
 - Mbulimi 80% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit
 - 20% e popullsisë, por jo më pak se 10% e popullsisë në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë, (zona urbane) janë mbuluar nga shërbimi i integruar i mbetjeve
- Afatmesem (2023-2028)
 - Zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake / vendore në të gjitha bashkitë
 - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MMN rajonale të të gjitha ZMM
 - Mbulimi i 90% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit
 - 25% e popullsisë, por jo më pak se 20% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbetjeve.
- Afatgjata (2028-2033)
 - 95% e popullsisë mbulohet nga shërbimi i grumbullimit të mbetjeve
 - 30% e popullsisë, por jo më pak se 30% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbeturinave.

Emri i Njësisë Fshatrat në përbërje të NJA Administrative

<i>Librazhd</i>	Qyteti Librazhd
<i>Qendër Librazhd</i>	Fshatrat: Librazhd Qëndër, Arrëz, Babje, Dorëz, Dragostunjë, Kuturman, Gizavesh, Librazhd Katund, Marinaj, Qarrishtë, Spathar, Togëz, Merqizë, Semes
<i>Hotolisht</i>	Fshatrat: Hotolisht, Dardhë, Vulçan, Buzgarë, Kokrevë, Vehçan, Xhyrë, Çerçan
<i>Lunik</i>	Fshatrat: Lunik, Prevall, Dranovicë, Kostenjë, Letëm, Zgosht, Koshorisht
<i>Stëblevë</i>	Fshatrat: Stëblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Sebisht, Moglicë, Prodan
<i>Polis</i>	Fshatrat: Polis, Mirakë, Gostimë, Sheh, Gurëshpatë, Vilan
<i>Orenjë</i>	Fshatrat: Orenjë, Floq, Gurakuq, Ballgjin, Rinas, Zdrajsh Verri, Zdrajsh, Neshtë, Mëxixë, Funarës

Tabela 2: Fshatrat në përbërje të NJA

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Librazhd

3.1.2 Hidrografia

Lumi Shkumbin përbën rrjetin kyesor hidrografik, por mund të përmendim një sërë përrenjsh, si përroi i Gorës, përroi i Madh, përroi i Zajës si dhe lumi i Rrapunit që derdhen në këtë lumë. Lumi i Shkumbinit furnizohet nga pellgu i tij që ka një sipërfaqe 2444 km² dhe ka një gjatësi 181 km dhe lartësi mesatare 753m. Hidrografia pasurohet edhe nga prania e 14 liqeneve akullnajore të vegjël, të cilët ndodhen në Parkun Kombëtar Shebenik- Jabllanicë, me një lartësi mbi 1,900m mbi nivelin e detit. Janë gjithashtu edhe dy lumenj që rrjedhin përmes zonës së Parkut me një gjatësi prej 22 km, përfshirë në veri lumin e Qarrishtës që bashkohet me lumin Rrapun dhe në jug lumin e Bushtricës që bashkohet me lumin Shkumbin.

Lidhur me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha (KUB) ka një mbulim të mirë me këtë shërbim. Bashkia është e pajisur me pusetat përkatëse dhe siguron një shtrirje të plotë. Përsa i përket njësive administrative, ky shërbim është shtrirë me anë të kolektorëve kryesore, pjesa më e madhe e këtyre njësive e sigurojnë këtë shërbim me anë të pusetave të krijuara nga vetë banorët. Vete rrjeti KUB është i amortizuar përveç zonave ku janë kryer punime rishtazi nga bashkia.

Bashkia gjithashtu është e pajisur me pusetat e drenazhimit të ujit. Relievi tepër i pjerrët në pjesën më të madhe të bashkisë ka ndikuar në krijimin e këtyre pusetave vetëm në zonat ku është e domosdoshme drenazhimi, për pjesën tjetër ajo kryhet në forma natyrale.

PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR I PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT TE BASHKISE LIBRAZHID
HARTA: HIDRGJEOLOGJIKE




Figura 2: Harta e hidrografisë
Burimi :PPV 2017

3.1.3 Burimet natyrore, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Burimet natyrore të Librazhdit janë si në vijim: burimet ujore tepër të pasura me prurje gjatë gjithë stinëve të vitit, si lumi Shkumbin, Lumi Rrapunit, zonat natyrore me status të vecantë si parku kombëtar “Shebenik Jabllanice”, si dhe zona e Steblevës. Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajore të vegjël me bukuri madhështore, të cilët ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra nivelin e detit. Parku ka drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështeka, bush, panje, shelg, lajthi, shkoze, mëlleze, qershii e egër, boronicë, gorricë, dardha e egër, trendafilii egër, caji i malit, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve.

Speciet kryesore te faunes jane: arriu i murrme, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lales, shqiponja, skifteri. Me te rralle jane: zardafi, derri i eger, kaprolli, dhia e eger, rreqebulli, gjeli i eger, trofta e malit.

Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

3.1.4 Demografia

Sipas CENSUS të vitit 2011, bashkia numëron 31,892 banorë ndërkohë që sipas regjistrit të gjendjes civile deri në fund të vitit 2024, kjo bashki ka një popullsi prej **43,863** banorë, me një

densitet prej **55.68 banorë/km**. Në Librazhd, rritja natyrore e popullsisë (raporti lindje- vdekje) është e stabilizuar dhe nuk është ky faktori që shkakton lëvizjet thelbësore në dinamikat e popullsisë. Nëse do të vërejmë lëvizjet mekanike (raporti të ardhur - të larguar) do të kuptojmë që ky është faktori i cili shkakton dinamikën kryesore të ndryshimeve demografike.

Rritja maksimale e popullsisë në qytetin e Librazhdit, referuar nga të dhënat e zyrës së gjendjes civile, ka ndodhur midis viteve 1990 – 1995 me 4.1 %. Dhe kjo, pasi kanë qenë vitet kur kanë ndodhur ndryshimet më drastike dhe lëvizjet më masive të popullsisë. Vihet re dukshëm rënia e popullsisë nga viti 1997, në vitin 1998 (-0.331%) dhe kjo është e shpjgueshme për shkaqet e pasigurisë që u krijua në shkallë vendi. Popullsia është në një rritje shumë të vogël (pothuajse zero) në vitin 1999 (0.086%), dhe më tej rënia e popullsisë vazhdon edhe për pesë vite të tjera, deri në vitin 2004, me rënie maksimale deri në vitin 2000 (-3.255%).

Rënia e theksuar e popullsisë sidomos ajo e vitit 2000, koïncidon edhe me vitin kur papunësia në qytet shënon përqindjen më të lartë në këto 7 vitet e fundit (27%).

Nga sa më sipër, konkludojmë se dinamikat e lëvizjes së popullsisë janë shumë të variueshme. Një tjetër fakt që vlen të përmendet, është lëvizja e brezave të rinj, të cilët largohen sapo mbarojnë arsimin e mesëm, lëvizje e cila përsëritet me një interval cdo 4- 5 vjet. Kjo tregon që është mjaft e vështirë të gjejmë një tendencë të qëndrueshme të dinamikave të popullsisë.




Figura 3: Dendësia e popullsisë
Burimi: PPV, Librazhd 2017


Konkluzion tjetër është se Bashkia Librazhd ka një popullsi mjaft të vogël e cila paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në zonë.

Popullsia	Sipas Census 2011	Sipas Rregjistrimit civil			Popullsia e korrigjuar ⁵
		viti 2017	viti 2018	viti 2019	
	31,892	44,247	43,551	43,732	35,444
Qyteti (përfshirë Nj.A Stebleve)	7,747	11,806	11,743	11,793	8,960.8
Hotolisht	5,706	7,208	7,087	7,088	6,120.6
Lunik	2,621	3,646	3,568	3,554	2900.9
Orenje	3,883	5,118	4,897	4,891	4,185.4
Polis	3,385	5,254	5,193	5,220	3,935.5
Qender	8,551	11,215	11,063	11,186	9,341.5

Tabela 3. Popullsia në Bashkinë Librazhd

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Librazhd.

Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e popullsisë në tre vitet e fundit, nga viti 2017 deri në vitin 2019, bazuar në të dhënat e marra nga zyra e gjendjes civile. Numri i popullsisë në qytet ka pësuar një rënie të vogël me 0.54 % nga viti 2017 në vitin 2018, dhe një rritje me 0.43% nga viti 2018 në vitin 2019. Në njësitë administrative si Hotolisht, Lunik dhe Orenjë ky numër ka pësuar një rënie të vogël, kurse në Polis dhe Qendër nga viti 2018 në vitin 2019 kemi një rritje të lehtë të numrit të popullsisë.



Grafiku 1: Shpërndarja e popullsisë 2017-2019

Popullsia e korrigjuar = Popullsia Census + Popullsia (GJC-census)*30%

3.1.5 Popullsia aktive dhe papunësia

Shpërndarja e papunësisë ndryshon nga zona urbane në ato rurale, këto të fundit numërojnë rreth dyfishin e banorëve të papunë të zonave urbane, ndonëse përqindja e papunësisë në raport me popullsinë totale përmbys plotësisht këtë raport duke bërë që shkalla e papunësisë në zonat rurale të jetë më e vogël në krahasim me zonat urbane. Kjo vjen si pasojë e përqëndrimit të popullsisë në qytete dhe zonat periferike rreth tyre.

Nga të dhënat e marra nga zyra e punësimit janë të regjistruar rreth 1,200 persona si punëkërkues të papunë. Kjo shifër mund të mos shprehë gjithë numrin e të papunëve në Bashkinë Librazhd, pasi shumë njerëz që aktualisht janë të papunë nuk vijnë të regjistrohen në zyrën e punësimit. Gjatë vitit 2018, me ndërmjetësinë e zyrës së punës janë punësuar rreth 166 persona. 136 persona janë punësuar në fasoneri, dhe rreth 30 persona në sektorin e shërbimeve.

Si në qytet ashtu dhe në fshat vërehet një numër i konsiderueshëm i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, një tregues indirekt i nivelit të varfërisë. Gjithashtu një përqindje të konsiderueshme zë dhe aftësia e kufizuar. Numri total i personave që trajtohen me pagesë paaftësie është 1,962.

<i>Njësia Administrative</i>	<i>Familje</i>	<i>Familje që përfitojnë Ndihmë Ekonomike</i>	<i>% ndaj totalit</i>	<i>Familje me PAK</i>
<i>Qyteti (përfshire Stebleven)</i>	4,226	200	4.7%	377
<i>Hotolisht</i>	2,354	437	18.60%	280
<i>Polis</i>	1,835	241	13.10%	185
<i>Qeder</i>	3,863	516	13.40%	380
<i>Lunik</i>	1,123	194	17.30%	110
<i>Orenje</i>	1,579	382	24.20%	185
TOTAL	14,980	1,970		1,517

Tabela 4. Numri i familjeve me ndihmë ekonomike dhe aftësia e kufizuar

Burimi: Zyra e ndihmes ekonomike, Bashkia Librazhd

3.1.6 Bizneset

Sektori më i zhvilluar i ekonomisë në bashkinë Librazhd është tregtia, që është tre herë më e madhe se sektori i dytë industria. Në të gjithë sektorët e ekonomisë vihet re ekzistenca e

ndërmarrjeve të vogla në përmasa, gjë që sjell ndikimin e kufizuar në qytet, si në jetën ekonomike ashtu edhe në numrin e të punësuarve.


Në territorin e bashkisë, nga të dhëna të marra nga zyra e tatim taksave, për vitin 2024 në Librazhd ushtrojnë aktivitet 804 subjekte aktive të rregjistruara në QKR dhe subjekte ambulante të rregjistruara pranë Bashkisë Librazhd. Në njësinë administrative Librazhd ushtrojnë aktivitetin 599 biznese (ose 70% e totalit të bizneseve të rregjistruara), nga këto 1/10 biznese janë biznese të mëdha. Në njësitë administrative ushtrojnë aktivitet 205 biznese, nga këto, 149 janë biznese të vegjël dhe 56 janë biznese të mëdha. Pjesa më e madhe e këtyre bizneseve e ushtrojnë aktivitetin e tyre në rrugën nacionale Elbasan-Korce dhe në akset kryesore që lidhin qytetin me njësitë administrative të tij.

Bizneset	Biznes i vogel	Biznes i madh
Qytet	478	121
Stebleve	9	6
Hotolisht	51	10
Lunik	7	6
Orenje	10	4
Polis	23	14
Qender	49	16
TOTAL	627	177

Tabela 5. Shperndarja e bizneseve ne njesite administrative

Burimi: Zyra e tatim taksave, Bashkia Librazhd

Grafikisht pesha që zënë bizneset e vogla dhe të mëdha për cdo NJA shprehet më poshtë.



Grafiku 2. Shperndarja e bizneseve ne njesite administrative

Burimi: Bashkia Librazhd

3.1.7 Rrjeti rrugor

Bashkia Librazhd ka akses shumë të mirë me rrugët me rëndësi kombëtare që kalojnë në territorin e saj. Autostrada Tiranë – Korçë, boshti qendror jugor Rruga E852, e cila nis nga Tirana, kalon në Librazhd deri në kufi me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas analizës së infrastrukturës rrugore, në Bashkinë Librazhd ka rrugë lineare të cilat shtrihen në periferi të qytetit si dhe mbizoterojnë në njësitë administrative me karakter rural. Gjendja e infrastrukturës nuk është e mirë, vetëm 30% rrugë të shtruara. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, ku nuk janë bërë shumë investime.

Struktura e rrjetit ekzistues rrugor në territor përbëhet nga një rrjet i përcaktuar dhe në një hierarki të saktë në varësi të rëndësisë dhe qëndrueshmërisë së funksioneve. Më poshtë paraqitet gjendja aktuale ekzistuese për Bashkinë Librazhd.

RRUGË	ZHVILLIM LINEAR	SIPËRFAQE
Rrugë shtetërore	30.000 m	270.000 m ²
Rrugë Kryesore	78.000 m	702.000 m ²
Rrugë dytësore	250.000 m	1.500.000 m ²
Rrugë terciare	500.000 m	3.000 m ²

Tabela 6: Te dhena për rrugët, gjendja ekzistuese Bashkia Librazhd
Burimi: PPV Librazhd 2017




Figura 4: Rrjeti infrastrukturës sipas kategorive.
Burimi: Bashkia Librazhd.

3.2 Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve




Figura 5. Skema e organizimit institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor

3.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me agjencitë e tyre respektive.

MTM është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektoriati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

MIE ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i lëndësve dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane.

MSHMS harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore.

MBZHR është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore. Rregullorja nuk është hartuar ende.

MFE është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për taksat e ndryshme mjedisore. Deri tani janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

AKUKIM - është përgjegjëse për zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve,

derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.

3.2.2 Organizimi në nivel rajonal

Inspektorati Mjedisor është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe teknologjitë.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai ka për detyrë të vendosë gjoba për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

3.2.3 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: bazuar në ligjin nr. 139/2015, ligjin 8094/1996, dhe në ligjin nr. 9010/2003, NJQVtë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga ministritë respektive;
- iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor për mbetjet, bashkitë kanë si detyrime si më poshtë:

- i. Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;

- ii. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- iii. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitim të përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- iv. Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- v. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
- vi. Të bashkëpunojë me Inspektoratin Mjedisor, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal.
- vii. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet

Diagrama më poshtë ilustron strukturën e bashkisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga përfaqësuesit në nivel Këshilli Bashkiak, Kryetar Bashkie, drejtuesit e shërbimeve dhe njësitë administrative.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave bashkiake për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligji 9537).

Policia e bashkiake: ushtron funksionin e saj bazuar në ligjin nr. 8224/1997, është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Numri i personave të angazhuar me shërbimet publike në organigramën e **bashkisë** është supervizori, një inspektor mjedisi pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe një specialist mjedisi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Gjithashtu pas korrikut 2018 kemi edhe ngritjen e një grupi pune me 3 persona për pasqyrimin e monitorimeve në terren gjatë kryerjes së transportit të mbetjeve nga stacioni i transferimit në incenerator. Grupi ka ndjekur ecurinë e punës për tre muaj dhe rezultoi se procesi vazhdoi çdo ditë normalisht, pa pasur asnjë problem. Mjeti teknologjik që transporton mbetjet për në incenerator nisej çdo ditë në orarin e caktuar.

Agjencia e Shërbimeve Publike ka në strukturë 97 vetë për shërbimet publike vendore por në tabelën e PBA vlerësohet se 28 vetë nga kjo agjenci punojnë për mbledhjen e largimin e mbetjeve inerte dhe atyre të gjelbra.

```

graph TD
    D[Drejtoria e Auditimit të Beroreshem  
(1+2)] --- KV[KRYETARI  
(1)]
    KV --- SK[SEKRETARI I KESHILLIT BASHKIM  
(1)]
    KV --- ZK[ZVKRYETARE  
(1)]
    KV --- K[KOBIET (14)]
    KV --- ZK2[ZVKRYETARE  
(1)]
    ZK --- N1[NJESIA ADMINISTRATIVE LUNK  
(7)]
    ZK --- N2[NJESIA ADMINISTRATIVE GENDER  
(10)]
    ZK --- N3[NJESIA ADMINISTRATIVE OREHJE  
(5)]
    ZK --- N4[NJESIA ADMINISTRATIVI HOTELIUSHI  
(7)]
    ZK --- N5[NJESIA ADMINISTRATIVE STEBEL  
(3)]
    ZK --- N6[NJESIA ADMINISTRATIVE POLIS  
(6)]
    ZK2 --- D1[DREJTORIA E PUNIME PUBLIKE  
(46  
(1+45))]
```

3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet

- **Rregulloren bashkiake për menaxhimin e mbetjeve:** e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbetjeve brenda territorit administrativ të bashkisë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitullin për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak. Bashkia nuk ka një rregullore të tillë.
- **Rregulloren bashkiake për tarifat e mbetjeve:** ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Rregullorja e tarifave të mbetjeve përfaqëson një politikë bashkiake afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e

mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin. Aktualisht Bashkia Librazhd nuk ka një rregullore të tillë.

3.3 Menaxhimi i Mbetjeve

Shërbimet e mbetjeve përfshijnë të gjitha aktivitetet lokale që lidhen me ofrimin e shërbimit të pastrimit apo elementë të tjerë të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Librazhd. Ky seksion merr në konsideratë dhe përshkruan të gjithë shërbimet e pastrimit, infrastrukturën aktuale për kryerjen e shërbimeve nga sistemin aktual të kontenerëve deri në incenerator, zonën e shërbimit, volumet e punës dhe frekuencat e shërbimeve, rrymat e mbetjeve që administron sot bashkia dhe konsumatorëve të cilëve u shërbehet.

Në këtë seksion identifikohen dhe vlerësohen të gjitha problematikat aktuale të sistemit të menaxhimit të mbetjeve apo shërbimeve të veçanta, si dhe jepen arsyet apo faktorët kryesorë që ndikojnë këtë gjëndje.

Si bazë të dhënash shërbeu informacioni i marrë nga Grupi i punës i ngritur në funksion të këtij plani.

Shërbimi i pastrimit në bashki kryhet nga subjekti i kontraktuar **“ALKO-IMPEX General Construcion”**, i cili kryen grumbullimin, pastrimin, Transportin e mbetjeve urbane nga Librazhdi për qytetin e Librazhdit për në Inceneratorin Elbasanit pranë Metalurgjikut”, . Kontrata **Nr. 3623 prot** është 52 muaj dhe është firmosur me **31.08.2020**.

Agjensia e Shërbimeve Publike Librazhd, pjesë e strukturës organike e Bashkisë Librazhd, kryen largimin e mbetjeve inerte dhe të gjelbra.

Ndërsa shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe hapësirave publike bëhet nga operatori **“ALKO-IMPEX General Construcion”** dhe Agjencia e Shërbimit Publik kryen mirëmbajtjen për rrugët urbane dhe rurale.

Numri i popullsisë që përfiton shërbimin e pastrimit të mbetjeve është **31,871** banorë. Përqindja e popullsisë që përfiton shërbimin e pastrimit është rreth 50%. Ndërsa po të shohim përqindjen e territorit që mbulohet me shërbim me grumbullimin e mbetjeve në zonat urbane është 100%, ndësa në atë rurale varion nga njësia në njësi.

Në dy Njësi Administrative: Njësia Steblevë dhe ajo Orenjë, për shkak të mungesës së infrastrukturës nuk ofrohet shërbimi i pastrimit të mbetjeve.




Figura 7: Mbulimi i shërbimit të mbetjeve Bashkia Librazhd
Burimi: Autori

3.3.1 Analiza e mbetjeve

Sipas të dhënave nga bashkia Librazhd, sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara që grumbullohen dhe transportohen gjatë vitit 2024 është rreth 7.88 ton/ditë dhe nuk përfshin mbetjet nga ndërtimet. Po ashtu fluksi më i madh i mbetjeve ashtu sikurse duken edhe në hartën bashkëlidhur shtrihet gjatë akseve kryesore rrugore. Nga vizitat paraprake të bëra në terren rezulton se trendi i mbeturinave inerte të krijuara nga ndërtimet është në rënje për shkak të bllokimit të lejeve të ndërtimit, megjithatë me zhbllokimin e tyre mendohet se mbeturinat inerte do vijnë gjithmonë në rritje dhe do të krijohen mjaft probleme në zonë.




Figura 8: Fluksi i mbetjeje
Burimi: PPV Bashkia Librazhd

Lidhur me shërbimin e pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane, qyteti i Librazhdit është i mbuluar 100% dhe frekuenca e pastrimit dhe largimit të mbetjeve është çdo ditë, ndërsa për zonat rurale ky shërbim ofrohet 2 herë në javë.

Sa i takon mbulimit të popullsisë sipas Njësive Administrative të Librazhdit, të dhënat rezultojnë sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Emertimi Zones	Popullsia sipas GJC	Popullsia e korrektuar	Popullsia që përfiton shërbim 2025
1	Zona 1 (qyteti)	11,853	11,853	11,853
4	Zona 2 (PPjesa jug-lindje e Bashkis)	8,540	8,540	8,540
5	Zona 3 (Pjesa veri-perendim e bashkis)	7,239	7,239	7,239
	Totali	27,632	27,632	27,632

*Tabela 7: Popullsia e mbuluar me shërbim
Burimi: Bashkia Librazhd*

Në NJA Qendër fshatrat që mbulohen janë: Dragostunje, Semes, Toge, Dorez, Kuturman.
 Në NJA Hotolisht fshatrat që mbulohen janë: Hotolisht qender, Frar, Dardhe, Xhyrë, Cercan.
 Në NJA Lunik fshati që mbulohet është Zgosht.
 Në NJA Polis fshatrat që mbulohen janë: Mirake plane, gjovac, Polis Gostimë, Polis Qender.
 Në NJA Orenj fshatri që mbulohet është: Funares
 Në NJA Stebleve fshatri që mbulohen janë: Fushestuden, borove

3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenerëve publik si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në incenerator.

Rruga që përshkruan aktualisht makina për mbledhjen e mbetjeve jepet në tabelën më poshtë:

Rruga që përshkruan Makina		Distanca (km)
Qyteti	Librazhd	14.854
NjA Qender	Dorez	6.2
	Kuterman	6
	Dragostunj	5
	Semes	1.5
	Toges	5
	Librazhd Qender	5.1
	Spathar	3.5
	Babje	8.2
NjA Hotolisht	Hotolisht	9.9
	Frare	6.2
	Dardhe	5.9
	Xhyre	1.9
	Cercan	1.8
	Ura e bushtrices	7.8
NjA Polis	Mirake 1	10
	Mirake 2	
	Polis gostim	3.2
	Polis Qender	2.8
NjA Lunik	Zgosht	5.5
	Lunik	7.4
NjA Orenj	Funares	7
NjA steblev	Fushe student	
	Borove	14.7

Tabela 8: Distanca që përshkruan makina teknologjike
 Burimi: Autori

Më sipër u evidentua përqindja e mbulimit me shërbim për familjet gjate vitit 2024. Ndërsa në tabelën e mëposhtme pasqyrohet mbulimi i shërbimit që u ofrohet bizneseve dhe institucioneve gjate viti 2024.

NjA	Biznese				Institucione			
	Biznese që përfitojnë		% e mbulimit		Institucione që përfitojnë		% e mbulimit	
	v.'24	v.'25	24	v.'25	v.'24	v.'25	v.'24	v.'25
Qender	65	65	100%	100%	1	1	100%	100%
Hotolisht	61	61	100%	100%	1	1	100%	100%
Lunik	13	13	100%	100%	1	1	100%	100%
Polis	37	36	100%	100%	1	1	100%	100%
Stebleve	15	15	100	100%	0	0	0	0
Orenje	14	14	100	100%	0	0	0	0
Bashkia	599	599	100%	100%	12	12	100%	100%

Tabela 9: Shperndarja e bizneseve ne njesite administrative
 Burimi: Zyra e Tatim Taksave, Bashkia Librazhd

Në të gjithë territorin e Bashkisë Librazhd janë 263 kontenjerë të vendosur (87 në qytet), ndërsa pjesa tjetër në zonat rurale. Kontenieret janë me kapacitet 1.1 m³. Në qytet vendosja e kontenierëve është në rrugët kryesore dhe nëpër lagje, ndërsa në njësitë administrative vendosja e kontenierëve është përgjatë rrugës kryesore si në tabelën e mëposhtme:

Shperndarja e konteniereve	Numri
Qyteti	87
Njesia Administrative Hotolisht	65
Njesia Administrative Qender	72
Njesia Administrative Lunik	8
Njesia Administrative Polis	26
Njesia Administrative Orenj	5
Njesia Administrative Steblev	0
TOTALI	263

Tabela 10: Shperndarja e konteniereve

Burimi: Zyra e Sherbimeve, Bashkia Librazhd

Më poshtë paraqitet harta e shpërndarjes së kontenierëve të mbetjeve urbane në Bashkinë Librazhd.





Figura 8: Shpërndarja e kontenierëve
Burimi: Zyra e Sherbimeve, Bashkia Librazhd

Sasia e gjeneruar e mbetjeve që mbliidhen në bashki nga zonat urbane rezulton 277.08 t/vit. Ndërsa për grumbullimin e mbetjeve në zonat rurale është përllogaritur 700 t/vit.


Pesha specifike përcaktohet në momentin që bëhet peshimi në inceneratorin e Elbasanit, për çdo mjet teknologjik që bën transportimin. Më poshtë jepet edhe sasia e mbetjeve që jane dërguar në inceneratorin e Elbasanit per vitin 2024.

Muaji	Sasia mesatare kg/dite	Sasia ton/dite
Janar	241,18	7.8
Shkurt	200,48	6.9
Mars	228,62	7.4
Prill	226,02	7.5
Maj	235,76	7.6
Qershor	227,18	7.6
Korrik	266,76	8.6
Gusht	285,44	9.2
Shtator	254,28	8.5
Tertor	238,26	7.7
Nentor	224,94	7.5
Dhjetor	248,16	8


Tabela 11: Sasia e mbetjeve që gjenerohen
Burimi: Zyra e Sherbimeve, Bashkia Librazhd





PLANI I VENDOSJES SE KONTENIEREVE TE KRETJEVE URBANE NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER BASHKIA LIBRAZHID SH 1:10000




PLANI I VENDOSJES SE KONTENIEREVE TE KRETJEVE URBANE NJESIA ADMINISTRATIVE HETOLISHT BASHKIA LIBRAZHID SH 1:15000



PLANI I VENDOSJES SE KONTENIEREVE TE KRETJEVE URBANE NJESIA ADMINISTRATIVE HETOLISHT BASHKIA LIBRAZHID SH 1:10000



PLANI I VENDOSJES SE KONTENIEREVE TE KRETJEVE URBANE NJESIA ADMINISTRATIVE POLIS BASHKIA LIBRAZHID SH 1:10000



PLANI I VENDOSJES SE KONTENIEREVE TE KRETJEVE URBANE NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER BASHKIA LIBRAZHID SH 1:100 000




Figura 9: Shpërndarja e kontenierëve pjesore sipas NJA

3.3.3 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve

Shërbimi i pastrimit, përvec grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane, ofron dhe fshirje dhe lagjen e rrugëve dhe trotuareve për zonën e qytetit. Nga totali i të gjitha sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve dhe shesheve, fshihen dhe pastrohen 104000 m²/ditë. Fshirje dhe pastrim të plotë përfitojnë rrugët, sheshet dhe trotualet e qytetit të Librazhdit (85 % e tyre), ndërsa NjA të tjera nuk e përfitojnë këtë shërbim. Ky shërbim ofrohet përditë dhe për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë 10 persona të punësuar me kohë të plotë.

Tabela e mëposhtme pasqyron në mënyrë më të detajuar sipërfaqet e pastrimit të shesheve, rrugëve dhe trotuareve.

Qyteti	Gjithsej	Fshihen	Totale
TOTAL	m ²	m ²	%
Rrugë, Trotuare, Sheshe	124000	104000	85 %

Tabela 12: Sipërfaqe rrugë, trotuare dhe sheshe

Procesi i fshirjes lidhet me aktivitetet e fshirjes me fshesë dhe grumbullimi i mbetjeve e transportimi i tyre me karrocë dore në vendgrumbullimin e tyre më të afërt.

Gjithashtu Bashkia Librazhd për periudhën maj-shtator të çdo viti ofron cdo ditë shërbimin e lagies për rrugët e qytetit, ku sipërfaqja e përllogaritur është 85 000 m²/ditë. Procesi i lagies kryhet me një mjet autobot, cdo ditë gjatë këtyre pesë muajve. Për kryerjen e këtyre shërbimeve ka të punësuar vetëm një person, i cili punon si shofer i mjetit që bën lagjen e rrugëve dhe trotuareve.

3.3.4 Depozitimi

Që nga korriku 2018, pas nënshkrimit të kontratës së re për largimin e mbetjeve të Librazhdit në Inceneratorin e Elbasanit, bashkia nuk depoziton më mbetje në venddepozitimin “Rrypzat e Lushit”. Ky vend depozitimi ka funksionuar që nga viti 2007 deri me vitin 2018 ka qenë i pajisur me leje mjedisore që nga viti 2013, ndërsa hyrja bëhej e kontrolluar dhe ishte pjesërisht i rrethuar. Distanca për transportin nga stacioni i transferimit deri në incenerator është 33 km vajtje.

Vend depozitimi ka qenë një grykë përroi ku pjesët anësore kanë qenë skarpata të thella dhe nuk ishte e mundur hyrja në vend depozitim (nga njerëzit apo kafshët), ndërsa në pjesën e poshtme është ndërtuar një pritë me gabjon rrjete teli që të mbajë mbetjet mos depërtojnë në përrua. Risqet për mjedisin janë pasi në të ardhmen mund të rriten gërryerjet dhe të gjitha leksivatet që mund të dalin nga dekompozimi i mbetjeve vazhdojnë në rrjedhën e këtij përroi ku kalojnë në një nga lagjet (zonë urbane) e qytetit të Librazhdit.

Momentalisht venddepozitimi Rrypzat e Lushit nuk është në funksion.

Lidhur me vendet ilegale të depozitimit të mbetjeve, si fenomen vërehet pothuasje në të gjitha zonat rurale të thella ku nuk ofrohet shërbimi i pastrimit. Në këto zona, njerëzit i grumbullojnë mbetjet buzë përrenjve, duke shkaktuar ndotje. Aktualisht nuk ka një numër të saktë të këtyre venddepozitimeve ilegale, pasi mbyllen dhe rihapen në mënyrë të pakontrolluar. Megjithatë duhet theksuar se venddepozitimet ilegale janë të përmasave të vogla. Aktivitete nga OJF mjedisore synojnë herë pas here ndërgjegjësimin e komunitetit për eliminimin e këtyre venddepozitimeve dhe kompostim të mbetjeve.

3.3.5 Riciklimi

Bashkia nuk kryen fare ndarje në burim të mbetjeve apo kompostimi në zonat rurale. Riciklimi i mbetjeve është në fazën fillestare, më shumë nga komuniteti rom dhe disa kolektorë të vegjël. Llojet kryesore që grumbullohen janë kanaçe, plastikë, letër, karton, plastmas dhe hekur. Nuk ka impiant të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme dhe të djegies së mbetjeve urbane. Vlen të përmendet firma Toçi shpk, e cila realizon grumbullimin dhe riciklimin e plastikës, me një sasi deri në 1ton/vit.



Figura 11: Kosha për ndarjen e mbetjeve
Burimi: Bashkia Librazhd

Ka patur iniciativa edhe nga OSHC-të, konkretisht “Albanatyra” në kuadër të projektit ReLoad për futjen e konceptit dhe zhvillimin praktik të ndarjes së mbetjeve në burim për 6 shkolla të Librazhdit dhe riciklimin e tyre. Projekti sapo ka filluar të aplikohet në këto shkolla dhe mbetet për t’u parë rezultatet që do të ketë. Gjithashtu janë vendosur dhe kosha për ndarjen e mbeturinave që në burim edhe në pika ku fluksi i njerëzve është më i madh, si në rastin e stacionit të autobusave.

Treguesit	NJA Librazhd	NJA Hotolisht	NJA Qender	NJA Lunik	NJA Polis	NJA Steblev
Popullsia e shërbyer	11,743 banorë	3,750 banorë	7,630 banorë	460 banorë	2,340 banorë	500 banorë
Norma e	0.6 kg/ditë	0.2 kg/dite	0.2 kg/dite	0.2 kg/dite	0.2 kg/dite	0.2 kg/dite

gjenerimit						
Mbetjet e gjeneruara	7,0458 ton/ditë	2,14 ton/dite				
Numi i kontenjerëve	89 kontenjerë 1.1 m ³	29 kontenjerë 1.1 m ³	47 kontenjerë 1.1 m ³	6 kontenjerë 1.1 m ³	18 kontenjerë 1.1 m ³	
Frekuenca	7 herë në javë	2 herë në javë				
Tipi i makinave	1 Makinë teknologjike 8 ton për grumbullimin e mbetjeve 2 makina teknologjike 3 ton, për transportin e mbetjeve në incinerator					
Mënyra e trajtimit	Incineratori i Elbasanit					
Sipërfaqe që fshihen	104000 m ² /ditë 49,328	Nuk ofrohet				
Sipërfaqe që lagen	85000 m ² /ditë	Nuk ofrohet				

Tabela 14: Treguesit kryesorë të shërbimit të pastrimit

IV. Ekonomia dhe Financimi

4.1 Buxheti vjetor dhe investimet

Buxheti i Bashkisë Librazhd është detyrim i bazuar në ligjit Nr. 139/2015, ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afat-mesëm”, me qëllim hartimin e strukturës së programeve që siguron përfshirjen brenda një programi shpenzimesh funksionet kryesore të njësisë.

Buxheti i Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019" paraqitet në formë tabelare, në lekë:

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE	Program	VITI 2025		
		SHPENZIME KORENTE	SHPENZIME KAPITALE	TOTALI
0 1110	Planifikimi , Menaxhimit dhe Administrimit	200.560.449	13.961.696	214.522.145
0 3140	Sherbimet Policore	7.559.653	0	7.559.653
0 10661	Strehimi	3.100.000	0	3.100.000
0 4240	Menaxhimi i infstrukturës së ujitjes dhe kullimit	2.655.550	14.773.616	17.429.166
0 4260	Administrimi i Pyjeve dhe kullotave	17.191.064	3.700.000	20.891.064
0 4520	Rrjeti rrugor rural	54.071.402	200.253.144	254.324.546
0 10430	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar (Qendra Ditore femijeve me AK)	8.520.896	0	8.520.896
0 6260	Shërbimet Publike	37.163.757	0	37.163.757
0 6260	Shërbimi pastrimit dhe transporti mbetjeve urbane	33.000.000	0	33.000.000
0 8130	Sport dhe argëtim	14.000.000	0	14.000.000
0 8220	Trashëgimi kulturore,evente artistike dhe kulturore	15.592.059	0	15.592.059

0 9120	Arsimi baze dhe parashkollor	134.724.267	8.960.007	143.684.274
0 9230	Arsimi Mesem i pergjithshem	3.994.313	8.288.510	12.282.823
0 10430	Çerdhja e femijeve	21.467.471	0	21.467.471
0 5100	Menaxhi I mbetjeve urbane	9.000.000	0	9.000.000
0 3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	23.520.720	0	23.520.720
0 4910	Fond rezerve	17.279.558	0	17.279.558
0 4940	Fond Kontigjence	2.000.000	0	2.000.000
0 3280	Emergjencat Civile	8.639.779	0	8.639.779
Shuma I		614.040.938	249.936.973	863.977.911

*Tabela 15: Ndarja e fondeve sipas sektoreve te bashkise
Burimi: Zyra e Financave, Bashkia Librazhd*

Në buxhetin e planifikuar të vitit 2024, programi i “Menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve publike” zë 1.6 % të totalit në buxhetin e shpenzimeve

4.2 Ndarja e kostove

Bashkia ka marrë në analizë shpërndarjen e buxhetit për pastrimin sipas nevojave dhe kostove të shërbimeve. Një analizë të hollësishme të kostove dhe shpërndarjes së buxhetit është realizuar vetëm gjatë përgatitjes së dokumentacionit për organizimin e tenderit të pastrimit gjatë analizës së çmimit të kontratës apo në rastet kur parashikohet në kontratë rishikim i këtij çmimi.

Shërbimi i pastrimit, bazuar në kontratat e nënshkruara me operatorin privat mbulon këto lloj shërbimesh:

1. Fshirje rruge me punëtore
2. Zbrazje kontenieri dhe largimi i mbetjeve urbane
3. Larje dhe dezinfektim i konteniereve të mbetjeve urbane
4. Freskim (lagia) rrugë e sheshe

Bashkia Librazhd	Viti 2024				Viti 2025	
	Buxheti total	Buxheti i Programit MM dhe shërbimet publike	Buxheti për shërbimin e ofruar	Buxheti total	Buxheti i Programit MM dhe shërbimet publike	Buxheti për shërbimin e ofruar

Vlera 000/lekë	1728528	32745	32745	863978	33000	33000
Pesha specifike e treguesit mbi buxhetin total (në %)	100%	1.12 %	1.12%	100%	1.6%	1.6%

Tabela 16: Buxheti i vitit 2024 dhe 2025 me peshën specifike për mbetjet
Burimi: Bashkia Librazhd

Gjatë vitit 2024, Bashkia shpenzoi rreth 31 milion lekë për shërbimin e pastrimit, përfshirë në këtë vlerë edhe koston e transportit për në incenerator. Gjatë vitit 2025 është planifikuar të shpenzohen rreth 41 milion lekë për këtë shërbim.

Kontrata Baze			Depozitimi		TOTAL	
Viti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti
2024	32,896,336.52	30,184.472.63	11,912,400	8,631,240	44,808,736.52	38,815,712.63
2025	41,139,030.40	-	11,244,000	-	52,433,030.40	-

Tabela 17: Shpenzimet e kontratave të shërbimit

Kostoja e shërbimit të pastrimit është në rritje nga viti në vit, duke qenë se synojmë një mbulim sa më të gjerë të të gjithë territorit të Bashkisë.

Për shërbimin e pastrimit, bazuar në kontratën ofrohen këto lloj shërbimesh me vlerat përkatëse për çdo zë, si në tabelën e mëposhtme:

Nëse do analizonim të dhënat e kontratës bazë, sipas zerave të shërbimeve, kemi këto të dhëna si më poshtë vijon:

Nr	Emertimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Fshirje rruge (punetore me krahe)	m ²	73399179	0.10	7339917.9
2	Zbrazje konteneri dhe largimin e mbetjeve urbane	ton	162171	218	35353278
3	Larje, dezinfektimi konteniereve të mbetjeve urbane	konteniere	7632	100	763200

4	Freskimi (lagia) rruge ,sheshe	m ²	38353428	0.1	3835342.8
---	--------------------------------	----------------	----------	-----	-----------

Tabela 18: Shpenzimet e kontrates bazë

Gjithashtu, bazuar në kontratën shtesë, shërbimet që ofrohen paraqiten në tabelë, bashkë me kostot për cdo shërbim.

Nr	Emertimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Zbrazje konteneri dhe largimin e mbetjeve urbane	konteniere	22720	218	4952960
2	Larje, dezinfektimi konteniereve te mbetjeve urbane	konteniere	688	100	68800
3	Sistemin dhe manipulim i mbetjeve urbane	ton	2499	150	374850

Tabela 19: Shpenzimet e kontrates shtese

Dy tabelat më lart, në mënyrë të përmblëdhur paraqiten:

Nr	Emertimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Fshirje rruge me punetore me krahe)	m ²	73399179	0.12	8807901
2	Zbrazje konteneri dhe largimin e mbetjeve urbane	konteniere	184891	261.6	48367485
3	Larje, dezinfektimi konteniereve te mbetjeve urbane	konteniere	8320	120	998400
4	Freskimi (lagia) rruge ,sheshe	m ²	38353428	0.12	4602411
5	Sistemin dhe manipulim i mbetjeve urbane	ton	13164	180	2369520
Shpenzime totale					65145718

Tabela 20: Shpenzimet e kontratës bazë dhe shtesë

Shërbimi i pastrimit të qytet përfshin aktivitete si më poshtë:

- Fshirje e rrugëve me punëtorë,
- zbrazje dhe largim i mbetjeve urbane,
- freskim i rrugëve dhe trotuareve
- sistemim dhe manipulim i mbetjeve urbane.

Secili nga këto lloje shërbimesh zë përqindjen e vet në koston totale të shërbimit të pastrimit. Largimi çdo ditë i kontenierëve (sipas kontratës) nga pikat e grumbullimit dhe transportimi i tyre në incenerator zë pjesën më të madhe të koston.

Aktivitetet përfshijnë:

- Automjetet e transportit sipas destinacionit të caktuar kryejnë transportin e mbetjeve në incenerator;
- Punëtorët e transportit që kanë për detyrë të heqin të gjitha mbetjet urbane nga pikat e grumbullimit, të bejnë fshirjen me fshesë dhe dezinfektimin me gëlqere të vend grumbullimit me një rreze prej 3m.
- Lagia e rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit realizohet me autobot për periudhën maj – shtator, dhe lagen rreth 85 000 m²/ditë sipërfaqe.

Shpenzimet për cdo lloj aktiviteti janë paraqitur të përmbledhur sipas tabelës së mëposhtme. Kështu, aktiviteti i fshirjes së rrugëve me punëtorë zë 36 % të koston së shërbimit të pastrimit për vitin 2025, zbrazja e konteniereve dhe largimi i mbetjeve urbane zë 53% të koston për vitin 2025. Shpenzimet vjetore për vitin 2025 llogariten të jenë rreth 52,000,000 lekë ose 5700 lekë/ton mbetje në vit.

4.3 Tarifat dhe realizimi i te ardhurave

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike ose jo brenda territorit të Bashkisë Librazhd. Tarifa e pastrimit paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit për vitin 2025, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e paketës fiskale 2025 janë si më poshtë:

Nr	GRUPIMI I TATIMPAGUESVE	Njesia	Vlera
A. Tarifa e pastrimit per bizneset dhe institucionet			
1.1	Per cdo subjekt te biznesit te vogel te artikujve industriale , artikujve te ndryshem kafe , bar- kafe,) transporti, sherbime (kepuçar , rrobaqepës , parukeri etj te ngjashme)	Lek/vit	7000
1.2	Per cdo subjekt te biznesit te vogel qe ndodhet ne zonen pedonale (zona A) Per cdo subjekt te biznesit te vogel te artikujve ushqimore , fruta perime ,bulmet ,bar- restaurante , bujtina, profesione te lira, prodhim, shitje lende ndertimi , inerte , ndertim , projekte , zbatime, konsulence. Per niptet sekondare te subjekteve te biznesit te vogel qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd.	Lek/ vit	11000
1.3	Per cdo subjekt te biznesit te vogel qe ushtrojne aktivitet me nje nipt dy aktivitetete ne te njejten vendodhje .	Lek/vit	16000
1.4	Per niptet sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane seline ne Bashkite e tjera (ose jane me kontrate te lidhur me Bashkine Librazhd)	Lek/vit	110000
1.5	Per subjektet e biznesit te madh , te regjistruar ne regjistrin e biznesit, ne zonen pedonale	Lek/vit	440000
1.6	*Per biznesin e madh subjekte juridik,supermarket te regjistruar ne regjistrin e biznesit jashte pedonales . *Per subjektet te biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit si bankat .	Lek/vit	220000
1.7	* Per cdo subjektet te biznesit te madh i regjistruar ne regjistrin e biznesit si : fondacionet. * Per cdo subjektet biznesit te madh , bar – restaurant , baste sportive hotele , motele bujtina . * Per cdo subjekt i profesioneve te lira, farmaci , te biznesit te madh. * Per cdo leje zhvillimore ndertimi mbi 4 kate per subjektet e ndertimit qe kane seli ne teritorin e Bashkise Librazhd. * Per ndermarrjet dhe institucionet shteterore,	Lek/vit	55000

	Per ndermarrjet dhe institucionet jo shtetereore qe kryejne sherbime dhe realizojne te ardhura		
1.8	* Per cdo njesi shitje te biznesit te madh ,ushqimore. * Per cdo njesi shitje te biznesit te madh materiale ndertimi, shitje lende drusore, industriale , kabllore , internet * Subjektet e biznesit te madh si : shitje karburantesh jashte rruges nacionale.	Lek/ vit	88000
1.9	Për cdo njesi prodhimi te biznesit te madh per fasonet .	Lek/vit	165000
1.10	Për çdo njësi prodhimi te biznesit te madh i vetepunesuar (jo fasone).	Lek/vit	110000
1.11	* Per kompanite e sigurimit me nipte sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd * Per cdo leje zhvillimore ndertimi me 4 kate per subjektet e ndertimit qe nuk kane seli ne teritorin e Bashkise Librazhd *Per subjektet e transportit te udhetareve te biznesit te madh	Lek/vit	27500
1.12	Per cdo firme ndertimi per seline administrative Bashkia Librazhd	Leke	44000
1.13	Per subjektet e transportit te mallit te biznesit te madh.	Lek/vit	33000
1.14	Subjektet e biznesit te madh si : shitje karburantesh ne rrugen nacionale	Lek/vit	110000
1.15	Per konvikte,pensione,shtepi femijesh,spitale shtetereore etj.	Lek/dhom/vit	150
1.16	Per tregtaret brenda tregut me kontrate me Bashkine	Leke/vend/muaj	100
1.17	Per OJF dhe shoqatat	Lek/ vit	8000
1.18	Per ambulantet	Lek/vit	2000

B. TARIFA PASTRIMIT PER FAMILJET QYTET

1.19	Pastrimi, largim mbeturinash per familjet	Lek/vit/familje	1500
1.20	Pastrimi, largim mbeturinash, per familjet me ndihme ekonomike, invalidet, te vetmuarit dhe veteranet e luftes.	Lek/vit/familje	600

Tarife pastrimi, largimi te mbeturinave ne 6 Njesite Administrative Librazhd.

Nr.	Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave	Njesia	Vlera e tarifes leke / ne vit
1.21	Ambulant	Lek/vit	2000
1.22	Per cdo subjekt te biznesit te vogel (shitje me pakice dhe shumice) Prodhim (biznesi i vogel) Sherbime e profesione te tjera per biznesin e vogel si ofr etj.	Lek/vit	6000
1.23	Subjektet e biznesit te vogel kultivim peshku, me shume se nje aktivitet ne nipt/license.	Lek/vit	20000
1.24	Sherbime dhe profesione te lira(biznes i madh)	Lek/vit	33000
1.25	*Subjektet e biznesit te madh si :kultivim peshku, projektme zbatime ,subjektet e ndertimit,prodhim inertesh.etj te ngjashme me to. * Per cdo njesi shitje te biznesit te madh(Bar-restorant,Lojra,fati,Baste sportive, Hotele,Motele) jashte rruges nacionale.	Lek/vit	44000
1.26	Per cdo njesi shitje te biznesit te madh, (Bar-restorant,Lojra,fati,Baste sportive, Hotele,Motele) ne rrugen nacionale	Lek/vit	110000
1.27	Subjektet e biznesit te madh si : Hec-e,	Lek/vit	220000
1.28	Subjektet e biznesit te madh si subjektet per shfrytezim minierash, gurore.	Lek/vit	165000
1.29	Pastrimi, largim mbeturinash per familjet	Lek/vit/familje	500
1.30	Pastrimi, largim mbeturinash, per familjet me ndihme ekonomike, invalidet, te vetmuarit dhe veteranet e luftes.	Lek/vit/familje	200

Tabela 21: Tarifa e pastrimit për bizneset sipas paketes fiskale 2025

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Për vitin 2025 numri i familjeve ne qytet që janë faturuar është 2562, ndërsa numri i familjeve që kanë paguar të paktën një herë gjatë vitit të fundit (viti 2024) është 2441 familje . Përqindja e mbledhjes së kësaj tarife për familjet rezulton 99%. Vetëm në vitin 2024 janë faturuar 846 biznese, nga të cilat kanë paguar vetëm 625 .

Grafiku 3: Niveli i pagesës sipas kategorive

Burimi: Autori

Në tabelën e mëposhtme jepet struktura e realizimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit për vitin 2024 në vlerën në lekë sipas grupeve të bazës tarifore, familje, biznese dhe institucione sipas % së realizimit të tyre nga planifikimi.

Viti	Treguesi	Vlera ne leke	Vlera ne leke	Vlera ne leke	TOTALI
		Familje	Biznese	Institucione	Leke
2024	Plan	3,234,000	15,056,000	1,210,000	19,500,000
	Fakt	3,217,015	17,801,596	1,155,000	22,173,611
	% realizimi				114%

Tabela 23: Treguesit e realizuar sipas kategorive


Burimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Mbledhja e të ardhurave sipas kategorive për vitin 2024 paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Realizimi për vitin 2024 ishte në masën 22,173,611 leke ,nga kjo për familjarët zene 14 % dhe 86 % për bizneset dhe institucionet.

Grafiku 4: Niveli i pagesës sipas kategorive

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Për vitin 2025 numri i familjeve që janë faturuar është 2465, ndërsa numri i familjeve që kanë paguar të paktën një herë gjatë vitit të fundit është 1944. Përqindja e mbledhjes së kësaj tarife për familjet rezulton 78.8%. Ndërsa në vlera më ulëta se familjet rezulton për qindja e mbledhjes së tarifës nga bizneset 71.3%. Vetëm në vitin 2024 janë faturuar 715 biznese, nga të cilat kanë paguar vetëm 510.



Grafiku 3: Niveli i pagesës sipas kategorive

Burimi: Autori

Në tabelën e mëposhtme jepet struktura e realizimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit për vitin 2024 në vlerën në lekë sipas grupeve të bazës tarifore, familje, biznese dhe institucione sipas % së realizimit të tyre nga planifikimi.

Mbledhja e të ardhurave sipas kategorive për vitin 2024 paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Bizneset grumbulluan 60% të të ardhurave për shërbimin e pastrimit për vitin 2024, ndjekur nga familjarët me 32% dhe institucionet me 8%. Realizimi për vitin 2024 ishte në masën 92% për familjarët, 91% për bizneset dhe 91% për institucionet.

4.4 Mbulimi i kostos së shërbimit

Bashkia e Librazhd ka një database elektronik të klientëve dhe agjenti tatimor është Ndërmarrja e Ujësjetës. Niveli i realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet është mbi 90% të planifikimit tyre. Sipas të dhënave nga zyra e tatimeve, shuma totale e mbledhur nga pagesa e tarifave (familje, biznese, institucione) rezulton të jetë **22.173.611** lekë për vitin 2024, ndërsa buxheti total i shpenzuar për shërbimin nga bashkia ishte **18.832.491** lekë.

Nga të dhënat kuptojmë që % e shpenzimeve mbulohen nëpërmjet tarifave dhe taksave.

Librazhd	Kosto operative e shërbimit	Të ardhurat e realizuara	% e mbulimit të koston	Kosto operative e shërbimit	Të ardhurat e planifikuara	% e mbulimit të koston
	32,896,336.52	22,173,611	61%	34.324.192,00	23,000,000	34%

Tabela 24: Mbulimi i koston operative nga të ardhurat
Burimi: Dokumenti i buxhetit 204-2025

Nga të dhënat kuptojmë që **61%** e shpenzimeve mbulohen nëpërmjet tarifave dhe taksave. Ndërkohë për 10 mujorin e vitit 2019, niveli i realizimit të të ardhurave nga tarifa e shërbimit të pastrimit është në vlerën 6.760.000 lekë. Duke përlogaritur mbulimin e koston nga realizimi i kësaj tarife (edhe pse 10-mujore), evidentohet se 34% e koston mbulohet nga tarifa e pastrimit.

4.5 Indikatorët e performancës së shërbimit të ofruar

Më poshtë paraqitet situata në fillim të vitit 2025 e menaxhimit të mbetjeve sipas indikatorëve të performancës.

1."Eficienca në grumbullimin e mbeturinave" - shpreh sasinë e mbeturinave të grumbulluara, nga kontraktori dhe agjensia e puneve publike kundrejt shumës totale të mbetjeve të gjeneruara. Ai ndahet në 2 nën tregues, duke pasqyruar zonën urbane / periurbane (C1.1) dhe zonat e largëta (C1.2). Në ditët e sotme të dhënat mbi sasinë e mbeturinave të grumbulluara ose të mbeturinave të transferuara në incenerator janë të besueshme dhe bazohen në matje, kështu që saktësia e të dhënave është e lartë. Shërbimi i pastrimit mbulon 100% zonën urbane dhe 35% zonën rurale (në dy Nj.Administrative nuk ofrohet fare ky shërbim).

2."Pastërtia e qytetit" - shpreh efektivitetin e grumbullimit të mbeturinave në rrugë dhe në zonat e largëta. Në qytet nuk ka prani të mbeturinave, në rrugë ka prani të moderuar të tyre. Në vlerësimin tonë ky tregues klasifikohet në kategorinë e mesme (rreth 49%) me nivel të ulët të saktësisë, sepse të dhënat vijnë vetëm nga stafi i bashkisë.

3. "Ripërdorimi - shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbeturinave "- përfaqëson raportin e sasisë së mbeturinave të mbledhura zyrtarisht nga një cikël i mbyllur nga pikat e grumbullimit deri në qendrën e trajtimit. Nuk ka të dhëna zyrtare për grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.Ka filluar të aplikohet në 6 shkolla ndarja në burim e mbetjeve, Sipas projektit ReLoad dhe mbetet për t'u parë rezultatet. Një përqindje e vogël e mbetjeve të riciklueshme grumbullohen nga bartësit e mbetjeve (joformale) ku vlerësohet si më pak se 5% e totalit të mbetjeve të grumbulluara.

4."Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në depozitimet e projektuara dhe të kontrolluara"- Të gjitha mbeturinat e mbledhura në Bashkinë Librazhd transportohen dhe depozitohen në Inceneratorin e Elbasanit. Nga ana tjetër, bashkia po merr masa për të rehabilituar venddepozitimet e vjetra.

5."Rikuperimi i kostos përmes tarifave" - krahason koston totale për ofrimin e shërbimit dhe financimin e tij përmes tarifës së miratuar dhe shkallës së arkëtimit. Të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e shërbimit të pastrimit për vitin 2024 janë 11.476.000 lekë, ndërsa kostoja vjetore e operimit është 52,000,000 lekë, kështu që kostoja e mbulimit përmes tarifave dhe taksave është në masën 60.9%.

5."Kontributi i qytetarëve për financimin e shërbimit"- niveli i mbledhjes së tarifës së miratuar reflekton kapacitetin / vullnetin e popullatës për të paguar tarifën. Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit për vitin 2024 janë **11.476.000** lekë, ndërsa të ardhurat totale të planifikuara

janë **10.500.000** lekë, kështu që niveli i grumbullimit është 109%. Megjithatë të ardhurat që grumbullohen nga tarifa e pastrimit mbulojnë vetëm 60% të kostos që bashkia shpenzon për këtë shërbim.

6."Transparenca e sistemit të faturimit" - vlerëson kapacitetin e bashkisë për të siguruar një faturë të duhur për të gjithë prodhuesit e mbeturinave. Vitin e kaluar tarifa është mbledhur përmes Ndërmarrjes së Ujit dhe fatura i është dërguar çdo klienti, por nuk është ndarë sipas llojit të taksave dhe tarifave. Kështu mund të themi se transparenca ka qenë e mesme.

Indikatore		Klasifikim i koduar me ngjyra			Saktësia e të dhënave
		E ulët	E mesme	E lartë	E ulët Mesatare E lartë
Cilësia e shërbimit	C1 zona e mbulimit të shërbimit				
	C1.1 mbulimi i shërbimit në zonën urbane dhe peri-urbane	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100% 100%	E lartë
	C1.2 mbulimi i shërbimit në zonën rurale	0 – 30 %	31 – 50% 35%	51 – 100%	E lartë
	C2 pastërtia e qytetit	0 – 32 %	33 - 66% 65%	> 66%	E ulët
	C3 perceptimi publik: shkalla e kenaqshmërisë së publikut me shërbimin	0 – 50%	51% -	81% - 100%	Nuk ka të dhëna
Qendrueshmëria mjedisore	D1 Ripërdorimi: shkalla e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane	0 – 5% 5%	5 – 20%	>20%	E ulët
	D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfille sanitare ose vend depozitime të aprovuara	0 – 30%	31 – 70%	71 – 100% 100%	Mesatare
Institucionale finan dhe ekonomike	E1 Mbulimi i kostos: tarifa mbulon koston.	0 – 35%	36 – 70%	71 – 100% 78.2%	E ulët
	E2 Si qytetarët kontribojnë në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100% 109%	E ulët
	E3 Transparenca me sistemin e faturimit	E ulët	Mesatare	E Lartë	Mesatare
Kosto e shërbimit		5615 Lek/ton 14.667.446 ALL për 2612 ton/vit 460 Lek / banorë / vit 14.667.446 ALL for 31,871 banorë të shërbyer			

Tabela 25: Indikatorët e performancës

V. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

a. Vizioni i planit

Grupi i punës për hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkinë Librazhd përpiloi vizionin, qëllimin dhe objektivat e planit të ri vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane duke marrë parasysh konsultimet me palët e interesuara dhe nevojat e shfaqura për një menaxhim sa më të mirë të mbetjeve urbane.

Në fund, duke u bazuar në prioritetet e bashkisë vizioni i planit të menaxhimit të mbetjeve urbane është:

“Prania e një mjedisi të pastër me shtrirje në gjithë territorin e bashkisë dhe eliminimi i mbetjeve urbane që grumbullohen në basenin ujëmbledhës të lumit Shkumbin.”

b. Qëllimi i planit

Qëllimi i planit të menaxhimit të mbetjeve urbane është të mbulojë me shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane territorin e bashkisë përmes bashkëpunimit me qytetarët dhe nxitjes së bizneseve ricikluese për mbledhjen e materialeve ricikluese në burim.

c. Objektivat e planit

Plani vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane synon përmirësimin e situatës aktuale, duke e shtrirë shërbimin e pastrimit në të gjithë territorin e banuar si dhe në zonat e turizmit malor. Plani është hartuar për një periudhë 5 vjecare, nga viti 2025 deri në vitin 2029.

Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale në përputhje me standartet kombëtare e ndërkombëtare. Fokusi në këtë plan do të jetë në marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të pastrimit në zona ku ky shërbim nuk ofrohet më parë, shtrirja e shërbimit të pastrimit në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar Shebenik – Jabllanice dhe në të gjitha monumentet e natyrës, përmirësimin e performancës bashkiake për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit si dhe rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Në vijim të vizionit të planit, si dhe bazuar në objektivat kombëtare, u hartuan objektivat strategjike të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve si më poshtë:

- Deri në vitin 2029 të kemi arritur shtrirjen e shërbimit të pastrimit deri në 85% të popullsisë.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për hedhjen e mbetjeve në venddepozitimet e caktuara në zonat ku shërbimi i pastrimit do ofrohet për herë të parë.

- Menaxhimi i mbetjeve urbane në zonat turistike si Parku Kombëtar Shebenik – Jabllanicë, Rezervati i Gjuetisë Kuturman dhe në të gjitha monumentet e natyrës deri në vitin 2029.
- Në vitin 2029 ulet sasia e mbetjeve urbane që dërgohen në incinerator në masën 20% krahasuar me vitin 2024.
- Nxitja e bizneseve ricikluese nëpërmjet favorizimeve me taksat vendore (partneritet për subjektet e ndihmës ekonomike) dhe mbështetja nëpërmjet formave të partneritetit publik privat.

4.1 Objekti i Planit

5.1.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake për të cilën Bashkia e Tepelenës është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- **Mbetje urbane** (ushqim, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj⁶), dhe
- **Mbetje të veçanta bashkiake** (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- **Mbetje të rrezikshme** që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë, rryma të tjera mbetjes klasifikohen si mbetje masive, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

5.1.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, rekomandohet që zona e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë të ndahen në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me infrastrukturën rrugore, frekuncen e mbledhjes dhe tipologjinë e popullsisë. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshtaten më mirë me

⁶ Siç përshkruhet në “Karakteristikat e Mbetjeve”

qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

1. Zona e qytetit (zonë urbane), ku frekuenca e pastrimit është cdo ditë, ofrohet grumbullim dhe largim i mbetjeve urbane, gjithashtu ofrohet fshirje e rrugëve dhe trotuareve si dhe lagje e rrugëve nga muaji maj deri në shtator. Në këtë zonë banon pjesa më e madhe e popullsisë, duke gjeneruar më shumë mbetje. Gjithashtu gjendet pjesa më e madhe e bizneseve (80% e tyre) dhe institucioneve. Kështu numri i popullsisë që do t'i shërbehet është 10,990 banorë, ku do të fshihen cdo ditë 50,239 m² dhe do të lagen 26,634 m² cdo ditë për një periudhë 5 mujore.
2. Zona 2 (zona rurale) ku përfshihet zona përgjate rrugëve nacionale, duke u përfshirë në këtë zonë disa fshatra të katër njësive administrative: Qendër, Polis, Hotolisht dhe Lunik. Shërbimi ofrohet përgjatë rrugëve kyesore hyrëse në cdo njërën nga njësitë, ku dhe janë përqendruar pjesa më e madhe e bizneseve. Në këto njësi shërbimi ofrohet dy herë në javë, duke ofruar grumbullim dhe largim të mbetjeve urbane. Në këtë zonë do të marrin shërbim 7,147 banorë dhe 143 biznese ku llogaritet të gjenerohen deri në rreth 2 ton mbetje në ditë. Fshatrat që përfshihen në këtë zonë janë: Hotolishti, Xhyra, Dardha, Dragostunja, Togëz, Dorëz, Kuturman, Mirakë Gjovac, Mirakë Plane dhe Semes.
3. Zona 3 (pjesa e Parkut Kombëtar Shebenik – Jabllanicë). Ashtu sikurse u theksua më lart, ndarja në nën-zona të vecanta për të ofruar shërbimin e pastrimit, bazohet në vecoritë territoriale të secilës zonë. Në pjesën e Parkut Kombëtar përfshihen fshatrat turistike si Fushë Studen, Steblevë, Qarrishtë, si dhe fshatrat si Gizavesh, Llangë dhe Kosharisht, me një numër total të popullsisë në këtë zonë deri në 2,832 banorë. Në zonë shërbimi do të ofrohet një herë në javë duke bërë të mundur grumbullimin dhe largimin e deri në 7 ton mbetje urbane në javë.

Zona (zona rurale e njësive administrative Qendër) ku janë përfshirë fshatrat si: Librazhd Qendër, Kuturman, Marinaj, Arrëz, Babje, Spathar dhe Mërqizë. Ky shërbim do t'i ofrohet në total 4922 banorë dhe ku llogaritet të gjenerohen deri në 1 ton mbetje në javë. Shërbimi do të ofrohet një herë në javë, ku do të ofrohet grumbullim dhe largim i mbetjeve urbane. Makina gjatë grumbullimit të mbetjeve urbane përshkruan një itinerar prej 81 km për përfundimin e gjithë zonës. Nisur dhe nga gjenerimi i mbetjeve urbane, në këtë zonë nevojiten 58 kontenierë për grumbullimin e mbetjeve.

(pjesa rurale e njësive administrative Hotolisht). Kjo zonë ka në përbërje të saj fshatrat si: Kokreve, Vulkan, Vehcan, Xhyre dhe Buzgare. Kjo zonë ka në përbërje 4,138 banorë ku gjenerohen 0.83 ton mbetje në ditë, duke pasur kështu nevojë për 48 kontenierë për mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve. Itinerari për grumbullimin e mbetjeve ka një gjatësi prej 80 km.

Zona (pjesa rurale e njësisë administrative Polis). Zona përfshin fshatrat si: Polis Gostimë, Gurshpatë, Vilan, Polis Qendër, Mirakë, Gjovac, Mirakë Plane, me një popullsi prej 1,452 banorë. Internerari i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve është 120 km, dhe në këtë zonë nevojiten 49 kontenierë.

Zona (pjesa rurale e njësisë administrative Orenjë). Shërbimi i pastrimit në këtë zonë shkon për herë të parë, fshatrat në përbërje të njësisë janë: Funares, Floq, Zdranjsh, Orenjë, Gurakuq, Ballgjin. Zona është llogaritur të gjenerojë rreth 0.77 ton në ditë, duke pasur nevojë kështu për 45 kontenierë. Internerari i mbledhjes së mbetjeve shkon deri në 51 km gjatësi.

Zona (pjesa rurale e njësisë administrative Lunik). Fshatrat në përbërje të kësaj njësie janë: Lunik, Prevalle, Neshte, Dranovicë dhe Mexixë. Internerari që do të përshkojë makina për mbledhjen e mbetjeve do të shkojë deri në 70 km. Zona ka në përbërje një popullsi deri në 1,781 banorë, me një normë gjenerimi deri në 0.36 ton në ditë, duke pasur kështu nevojë për 20 kontenierë.

Zona (pjesa rurale e njësisë administrative Steblevë). Zona ka në përbërje fshatrat si: Zabzun, Borovë, Sebisht, me një popullsi prej 390 banorë ku norma e gjenerimit shkon deri në 0.56 ton/javë. Internerari që përshkon makina llogaritet deri në 33 km, kjo zonë ka nevojë për 5 kontenierë për mbulimin e plotë të shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane.




Figura 12: Zonimi ishërbimit
Burimi: Autori

5.2 Skenarët e administrimit të mbetjeve

5.2.1 Skenari i riciklimit të mbetjeve

Bazuar në objektivat e planit të ri vendor për menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Librazhd, synohet të ulet sasia e mbetjeve urbane që dërgohen në incinerator. Ajo që duam të arrijmë është mbledhja e mbetjeve të riciklueshme, duke cuar kështu direkt në uljen e sasisë së mbetjeve që dërgohen në incinerator. Iniciativat për ndarjen e mbetjeve duhet të bazohen në sistemin e ndarjes së mbetjeve në burim, duke ndarë që në burim plastikën që mund të riperdoret. Ky skenar riciklimi do të mund të zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku ndarja në burim do të ishte më e thjeshtë dhe ku grumbullohet sasia më e madhe e mbetjeve, krahasuar kjo me sasinë e mbetjeve që gjenerohen në fshat.




Figura 13: Skema ideale e mbledhjes së mbetjeve

Duke u kthyer edhe një herë tek objektivat e planit të menaxhimit të mbetjeve urbane, theksohet:

- Ulja deri në masën 20% e mbetjeve urbane, kryesisht plastikë, që dërgohen në incinerator deri në vitin 2029.

Nëse Bashkia do të zbatonte këtë objektiv afatshkurtër deri në vitin 2029, pra do të diferenconte në burim mbetjet duke i grumbulluar në kontenierë të vecantë, atëherë sasia e mbetjeve që dërgohen në incinerator do të ulej. Nëse ulet sasia e mbetjeve që dërgohen në incinerator, do të ulet dhe kostoja e transportit. Tabela më poshtë jep përllëgaritjen e sasisë së mbetjeve që do të

mund të ricikloheshin, nëse do të bëhej ndarja në burim e tyre. Kështu gjatë vitit 2019 sasia e mbetjeve vjetore që dërgohen është 2,796 ton. Nëse gjatë vitit të parë, vitit 2020 do të ulej sasia e mbetjeve me 5%, do të shmangej nga incinerimi sasia e 139 ton mbetje. Nëse kjo përqindje do të rritej vit pas viti, deri në vitin 2024 do të shmangej nga incinerimi 559.2 ton mbetje krahasuar me sasine e mbetjeve të vitit 2019.

Objektivi sipas PVMMU	Njësia	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Ulja deri në 20% e mbetjeve urbane në vitin 2029	Ne %	0 %	5%	8%	12%	17%	20%
Do të përfundojë në landfill	Ton / vit	2,877.08 ton/vit	3,298 ton/vit	4,897 ton/vit	4,882 ton/vit	4,865ton/vit	4,854 ton/vit
Riciklohen	Ton / vit	0	19 ton /vit	30 ton/vit	45 ton/vit	62 ton/vit	73 ton/vit

Tabela 26: Sasia e mbetjeve që shmangen nga incinerimi nepermjet riciklimit (nqs do të operonin kompani riciklimi)

Kështu, deri në vitin 2029 sasia e mbetjeve që dërgohen në incinerator do të ulej me 20% krahasuar me vitin 2024⁷, duke shmangur kështu deri në vitin 2029 në total 559 ton, e menduar që është plastikë që riciklohet. Skema e riciklimit të mbetjeve mendohet të zhvillohet vetëm në zonën e qytetit.

Duke qënë se në Librazhd operon edhe firma ricikluese e plastikës, kjo firmë mund të hyjë në partneritet me bashkinë për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të riciklueshme. Kjo do të sillte kursim të koston së transportit sipas tabelës më poshtë.

Kosto transporti që kursehet	Njësia	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Kosto transporti	Lekë/ ton	2,243	2,144	2,271	2,139	1,865
Sasia e mbetjeve që diferencohen dhe nuk shkojnë në incenerator	Ton/ vit	19	30	45	62	73
Përfitimi i bashkisë nga kursimi i koston së transportit	Lekë/ vit	42617.00	64320.00	102195.00	132618.00	136145.00

Tabela 27: Kosto që kursehet nga skenari i riciklimit të mbetjeve (nqs do të arrihet të bwhet)

⁷ Supozimi këtu është plastika që 11% të totalit të mbetjeve të gjeneruara në bashki (bazuar dhe në dhënat e PKMIM Qarku Elbasan)

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga kontrata aktuale e shërbimit të pastrimit, për një ton mbetje të dërguar në incenerator, bashkia shpenzon 8731 lekë. Kështu gjatë vitit 2025, nëse do të shmangej nga incerimi sasia e 139 ton mbetje, do të kishte shpenzime më pak për transportin e kësaj sasia. Pra për 19 ton mbetje do të kurseheshin 42,617 lekë. Nëse sasia e mbetjeve që riciklohen rritet nga viti në vit, po kështu do të ulet edhe kostoja e transportit, derisa në vitin 2029 ulet me 136,145 Lekë.

Pra në total, përgjatë 4 viteve, nëse do të realizohet skenari i riciklimit të mbetjeve do të kursehej nga totali i koston së shërbimit 477,895 lekë në total.

5.2.2 Skenari i grumbullimit miks të mbetjeve

Kjo skemë e grumbullimit miks të mbetjeve, është vazhdimi i skemës aktuale të mbledhjes së mbetjeve dhe mbështetet në një sistem të përbashket të grumbullimit të mbetjeve, ku konsumatorët janë të detyruar të nxjerrin jashtë dhe të grumbullojnë mbetjet në pikat e caktuara, pra kontenierët e vendosur në cdo zonë ku ofrohet shërbimi. Më pas është operatori i shërbimit ai që bën mbledhjen dhe largimin e mbetjeve për në vendin e caktuar për trajtim, pra në incenerator. Më poshtë paraqitet skema e thjeshtë e menaxhimit të mbetjeve.




Figura 14: Skema e menaxhimit miks të mbetjeve

Sipas skemës, familjet, bizneset dhe institucionet cojnë në pikat e grumbullimit të gjitha mbetjet që gjenerojnë dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato dërgohen në incinerator, ku dhe realizohet trajtimi i tyre. Kjo skemë nuk bën ndarje në burim të mbetjeve.

Venddodhja e kontenierëve

Duke iu referuar sistemit aktual të mbetjeve, çështjet që duhen marrë në konsideratë janë:

- Është e rëndësishme që shpërndarja e kontenierëve të mbulojë sa më shumë zonën e mbetjeve në mënyrë që konsumatorët të kenë mundësi dhe lehtësi për t'i përdorur për hedhjen e mbetjeve, por njëkohësisht duhet të mundësohet infrastruktura rugore e nevojshme për vendosjen e kontenierëve dhe lëvizjen e makinës teknologjike.
- Venddodhja dhe dendësia e kontenierëve lidhet drejtpërsëdrejti me dendësinë e popullsisë në atë zonë si dhe me infrastrukturën dhe hapësirat e nevojshme. Kështu për zona të ndryshme brenda qytetit kemi distanca të ndryshme midis kontenierëve apo largësi të ndryshme nga konsumatorët. Aty ku dendësia e popullsisë është më e madhe, dhe numri i kontenierëve të vendosur është në rritje. Për sasinë e kontenierëve të vendosur në cdo pikë është marrë parasysh dhe sasia e përlogaritur e gjenerimit të mbetjeve.

Kapaciteti dhe infrastruktura

Për të realizuar përmbushjen e objektivave të vendosura në planin e menaxhimit të mbetjeve urbane, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme që në këtë rast është blerja e kontenierëve shtesë. Fillimisht përcaktohet kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e shërbimit. Aktualisht në përdorim janë kontenierë me kapacitet 1.1m³, të cilët konsiderohen më të përshtatshëm për këtë skemë grumbullimi mbetjesh. Kështu edhe në zonat e reja ku do shtohet shërbimi i pastrimit, kontenierët do të jenë me kapacitet 1.1m³.

Në tabelën e mëposhtme rekomandohen disa standarde të largësisë mesatare mes llojeve të ndryshme të zonave urbane ku respektimi i tyre varet nga infrastruktura e përshtatshme dhe hapësirat e nevojshme për vendosjen e PGM.

Tipet e zonave	Shumë të dendura	Të dendura	Mesatar	Të rralla
Distanca mesatare (m)	50-100	100-150	150-200	200-250

Tabela 28: Dendësia e PGM-ve

Llogaritja e numrit të nevojshëm të kontenierëve

Llogaritja e numrit të kontenierëve të domosdoshëm për grumbullimin e mbetjeve është në funksion të tre faktorëve të domosdoshëm që janë gjenerimi i mbetjeve nga bizneset, familjet dhe institucionet, frekuenca e mbledhjes së tyre dhe kapaciteti i kontenierit. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inerte apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh të medha duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit. Tabela e mëposhtme përmbledh nevojat për kontenierë duke filluar nga viti 2025 duke përfshirë edhe zonat e reja ku do të shtohet si shërbim.

Nr	Emertimi Zones	Frekuenca mbledhjes dite /jave	Gjenerimi (kg/dit)	Gjenerimi (ton/dit)	Kapaciteti i kontenierit	Koeficienti mbushjes	Nevoja Kazane kontenier
1	Zona 1	7	7100	7.1	1.1	85%	103
2	Zona 2	2	1600	1.6	1.1	85%	88
3	Zona 3	2	1600	1.6	1.1	85%	83
Totali							274

Tabela 29: Llogaritjes së kontenjerëve sipas frekuencës së shërbimit dhe mbetjeve të gjeneruara

Pra për mbledhjen miks të mbetjeve sipas frekuencave të propozuara, bashkia duhet të shpërndajë në vitin 2025 në territorin e saj 274 konteniere në pikat e përcaktuara. Nga 235 konteniere që janë aktualisht, duhen shtuar 39 konteniere të rinj, kryesisht nëpër njësitë administrative ku shërbimi nuk ofrohet më.

Në tabelë tregohet edhe shpërndarja e kontenierëve nga viti 2025 deri në vitin 2029

Numri i kontenierëve sipas zonave	Numri aktual gjendje	Parashikimi i kontinerëve 2025-2029				
		viti				
		2025	2026	2027	2028	2029
Zona 1		103	103	103	103	103
Zona 2		88	93	98	100	100
Zona 3		83	88	95	98	98
Mirembajtje/rezerve		10	10	10	10	10
Total		284	294	306	311	311

Tabela 30: Numri i nevojshëm i kontenierëve për vitet 2025-2029

Për vitet e tjera Bashkia duhet të shtojë numrin e kontenierëve në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve. Pra sipas tabelës, deri në vitin 2025 numri i kontenierëve do të jetë 274 konteniere duke shtuar në total me 2 kontenierë të rinj. Gjithashtu, për efekt të amortizimit të kontenierëve, në këtë numër shtesë janë parashikuar dhe 10 kontenierë, të cilët do të përdoren në momentet e largjes së kontenjerëve apo dhe në rastet e amortizimit të kontenierëve që aktualisht janë në përdorim.

Makinat për grumbullimin e mbetjeve

Makinat tipike për grumbullimin e mbetjeve janë zakonisht me kapacitet 5 dhe 10 ton. Këto makina apo kamionë teknologjik sugjerohen të përdoren në varësi të terrenit dhe popullsisë. Në zonat rurale sasia e përlogaritur e mbetjeve urbane është shumë herë më e vogël se në qytet, kështu do të rekomandohej që në zonën rurale të përdoret një kamion 5 ton kurse në zonën urbane një kamion 10 ton. Aktualisht në përdorim për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve urbane përdoret një kamion me kapacitet mbajtës deri në 8 ton.

<i>Zonat e shërbimit</i>	<i>Mbetje te gjeneruara (ton/dite)</i>	<i>Mbetje te gjeneruara ne vit (ton/vit)</i>
Zona 1 qytetit	7.1	2591
Zona 2	1.6	540
Zona 3	1.6	540

Tabela 31: Sasia e mbetjeve që gjenerohen në ditë dhe në vit

- Itinerari i grumbullimit të mbetjeve dhe transporti i tyre

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të grumbullimit dhe transportimit lidhen drejtpërsëdrejti me itinerarin e përzgjedhur të lëvizjes së makinës si dhe me kohën efektive të punës gjatë ndalesave në çdo PGM. Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve⁸. Për të përmirësuar kohën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duhet të merren në shqyrtim itinerarët aktualë në zbatim të parimeve të listuara më poshtë:

- Itinerarët nuk duhet të copëtohen apo të mbivendosen. Secili itinerar duhet të jetë kompakt, i përbërë nga segmentet e mbledhura në të njëjtën zonë gjeografike;
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë autoparkut që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;
- Shërbimet në rrugët pa krye mund të konsiderohen si shërbime për segmente rruge që mund të ndërpriten, përderisa ato mund të mblidhen vetëm duke kaluar poshtë segmentit të rrugës. Për të mbajtur kthesat djathtas në minimum, (në vendet ku automjetet lëvizin në krahun e majtë), mbledhja e mbetjeve nga rrugët pa krye bëhet kur ato janë në të majtë të kamionit. Këto mbetje duhet të mblidhen duke ecur për poshtë, mbrapsht apo duke bërë një kthesë në formë U;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo lehtëson mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant.

⁸ Koha e grumbullimit të mbetjeve për një pikë me 2 kontenierë të shkojë nga 2.5-3 min.

- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.

Pas verifikimit të plotësimit të parimeve të mësipërme, është e rëndësishme të bëhet matja/testimi i kohës reale të grumbullimit të mbetjeve.

5.2.3 Buxhetimi në bazë aktiviteti

Metodologjia e përdorur është buxhetimi në bazë të programit, mbështetur në ligjin 9936/2008 “Për menaxhimin financiar në RSH” dhe në ligjin organik 139/2015: “Për vetëqeverisjen vendore” ku sipas nenit 23 (pika 10) *Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve përfshihet në programin e shërbimeve publike.*

Llogaritja e koston për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë e Librazhdit, është bazuar në **VKM 319/2018** për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe modelin e përgatitur nga dldp.

Përlllogaritja është bazuar në blloqet vijuese:

- Të dhënat përmbledhëse për zonën administrative,
- Investime kapitale (kamionë dhe kontenierët e nevojshëm),
- Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel),
- Kostoja për largimin në “landfill” (tarifa e depozitimit) është zero në momentin aktual,
- Kostot e amortizimit (ri investimit),
- Kostot administrative

A. Fshirja dhe larja e rrugëve

Bashkia synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe rritjen e zonës të mbuluar me shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shesheve, duke përfshirë përveç zonës urbane dhe një pjesë të zonës rurale.

Aktualisht, mbulohet me shërbim fshirje sipërfaqja prej cdo dite 167000 m² rrugë, trotuare dhe sheshe. Gjithashtu lagen cdo ditë 113000 m² për një periudhë 5 mujore.

Metodologjia e pastrimit të rrugëve është jo shumë efikase (nuk përdoren makina fshesë) dhe kjo metodologji do të përdoret dhe për 5 vitet e ardhshme, pra do të vazhdohet të fshihet me punëtorë (në mënyrë manuale).

Politikat, objektivat dhe kostot e shërbimit **Politikat 2025-2029**

i. Shërbimi i fshirjes së sipërfaqeve

- Bashkia do të përfshijë në shërbimin e fshirjes, të gjithë rrugët e trotualet e qytetit të Librazhdit dhe qendrat të NjA të cilat aktualisht nuk e përfitojnë këtë shërbim.
- Do të vazhdojë fshirja e të njëjtës sipërfaqe në NjA Librazhd dhe do të përfshihen në shërbimin e pastrimit sipërfaqe të reja të NjA të tjera që do të rikonstruktohen apo asfaltohen, sipas programit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bashkia dhe objektivave më afatgjatë në këtë sektor.
- Frekuenca e shërbimit në vitet e ardhëshme do të shtohet, në çdo ditë të javës, duke mos rënduar koston e shërbimit, por duke mirëmenaxhuar fuqinë punëtore në të gjitha llojet e shërbimit brenda funksionit të shërbimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit.

ii. Shërbimi i larjes së sipërfaqeve

- Do të vazhdojë të laget e njëjta sipërfaqe në NjA Librazhd.

Kosto për çdo aktivitet

Kur flasim për aktivitete të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe shesheve, ato përfshijnë:

- fshirje me fshesë çdo ditë në muaj e 104000m² pedonale, trotuare dhe sheshe për qytetin e Librazhdit.
- mbledhje e mbetjeve nga fshirja dhe nga koshat e vegjël të mbetjeve;
- depozitimi i këtyre mbetjeve në pikat e afërta të grumbullimit (kontenierët);
- lagija e përditshme e sipërfaqeve prej 85000 m², të përcaktuara si më sipër në sezonin përkatës;

Standarti i shërbimit

- a) Fshirje me fshesë çdo ditë në muaj e sipërfaqes prej 104000m,
- b) Lagie çdo ditë për periudhën 5- mujore, nga 1 maj-30 shtator 85000 m², sipërfaqe,
- b) Norma e fshirjes rreth 7,500 m²/punëtor,
- c) Norma e lagies 153 ditë pune në vit.

Llogaritja e qendrave të koston për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2025.
- ✓ Llogaritjet e fuqisë punëtore janë bërë sipas kodit të punës për 40 orë në javë, pra shtohen puntorë rezervë për të zëvendësuar ditët e pushimit, festave, lejes së zakonshme dhe të ndonjë raporti mjekësor.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet për vitin 2024, u përdor si referencë për llogaritjen e koston operative në vitet 2025-2029, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2024 rriten mbi bazën e sipërfaqeve të reja që Bashkia vendos të shtohen sipas mundësive buxhetore.

Kosto Fshirjen e rrugëve (000/Leke)	2025	2026	2027	2028	2029
Librazhd	5,448	5,448	5,448	5,448	5,448
Shuma	5,448	5,448	5,448	5,448	5,448
Lekë për m ² fshirje	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3

Tabela 32: Kosto e fshirjes së rrugëve

Kosto lagies se rrugëve/shesheve (000/Leke)	2025	2026	2027	2028	2029
Librazhd	1495	1495	1495	1495	1495
Shuma	1,495	1,495	1,495	1,495	1,495
Lekë për m ² larje	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4

Tabela 33: Kosto e lagies së rrugëve

Në anekse gjeni llogaritjen analitike të kostos së fshirjes dhe lagies së rrugëve.

Mbledhja, largimi⁹ dhe transporti miks i mbetjeve

Mbledhja dhe llogaritja e të dhënave për periudhën 2024-2029, shërbeu për kuptimin dhe vlerësimin e situatës aktuale që lidhet me investime kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera administrative. Informacioni u përpunuar nga grupi i punës me personat përgjegjës për NJQV-të, si dhe bazat e të dhënave duke shfrytëzuar hartat, dokumentet strategjike, planet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, dhe referencat e raporteve të ndryshme.

Supozimet:

- ✓ Supozohet se Zonat I-rë do t'i largojnë mbetjet nga kontenierët 7-ditë në javë, Zona e II-të do t'i largojnë 2 herë në javë, Zona III-të do t'i largojnë 2-herë në javë,
- ✓ Normalisht një kamion 10 ton që grumbullon mbetjet duhet të vizitojë të gjithë zonën administrative 1+2 (pikat e grumbullimit), duke udhëtuar përreth derisa kamioni të mbushet plot. Më tej, ai drejtohet në pikën e transferimit të përkohshëm dhe prej aty një mjet tjetër teknologjik i con mbetjet në inceneratorin e Elbasanit. Kjo përkon me një turn

⁹ Per termin “mbledhje dhe largim” sipas ligjit 139/2015, mund te perdoret fjala permbledhese “grumbullim

ose përfundimin e shërbimit të grumbullimit për një ekip 1 shofer plus 2 punonjës. Dhe një kamion tjetër 5 ton do të përdoret cdo ditë për të grumbulluar dhe larguar mbetjet nga NJA të ndryshme. Gjendja e rrugëve është shumë e rëndësishme pasi kjo lidhet kryesisht me konsumin dhe kostot e amortizimit dhe, për më tepër me kohën e shpenzuar për grumbullimin. Rrugët e shtruara përmirësojnë shumë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Distancat të cilat u morrën në konsideratë janë:

- Distanca për grumbullimin, për të mbushur një kamion,
- Distanca për transportin, për të shkuar dhe kthyer nga pika e transferimit të përkohshëm.

Rezultatet e mbetjeve të gjeneruara, për qëllime të llogaritjes së kostos, janë llogaritur për vitin 2020 të ndara në 2-gjashtëmujor. Kjo për arsyen e mbylljes së shërbimit të kontraktuar me operator privat deri në 30 Qershor 2020, dhe vijimin e këtij shërbimi me skemë re, të dhënat e të cilave jepen në tabelat e mëposhtme:

TE DHENAT BAZE				
Emri i Zones se Mbetjeve (NjA)	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III
Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve	Nr.	7	2	2
Kategoria		Urban	Rurale	Rurale
Popullsia dhe biznesi i shërbyer në këtë zonë	Nr.	11,843	8540	7240
% e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	%	-	-	-
Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)	Nr.	11,843	8540	7240
Rrugët (distanca nga Landfilli vajtje-ardhje)	Km	66	66	66
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit/turn për një kamion)	Km	15	155	123
Mbetjet e gjeneruara per njesi (banor, biznes, institucion)	kg/njesi/dite	7,100.0	1,600.0	1,600.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	7.1	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	7.1	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve sipas frekuencës	ton/dite	7.7	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruar	ton/vit	2591	540	540

Tabela 34. Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh 6-Mujori I-re 2020

TE DHENAT BAZE				
Emri i Zones se Mbetjeve (NjA)	Njësia	Z. I	Z. II	Z. III
Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve	Nr.	7	2	2
Kategoria		Urban	Rurale	Rurale

Popullsia dhe biznesi i shërbyer në këtë zonë	Nr.	11,843	8540	7240
Rrugët (distanca nga Landfilli vajtje-ardhje)	Km	66	66	66
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit/turn për një kamion)	Km	14	155	123
Mbetjet e gjeneruara për njësi (banor, biznes, institucion)	kg/njësi/dite	7,100	1,600	1600
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	7.1	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	7.1	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve sipas frekuencës	ton/dite	7.1	1.6	1.6
Totali i mbetjeve të gjeneruar	ton/vit	2,591	540	540

Tabela 35: Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh viti i I

Të gjitha shifrat e mësipërme kanë të bëjnë me mbetjet e ngurta urbane, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të standardeve për menaxhimin e tyre.

Politikat, objektivat dhe kostot

Sipas skemës miks të prezantuar më sipër familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenierët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre.

Politikat 2025-2029

Mbi plotësimin e bashkise me kontenierët e nevojshëm

- ✓ Në vitin e parë të planit në 2025-tën, Bashkia ka të plotësuar në masen 85% të kontenierëve për mbulimin e zonave të shërbimit të bashkisë, duke pas në dispozicion 235 kontenier, sipas gjenerimit të mbetjeve në dy zonat e mbuluara me shërbim në vitin aktual.
- ✓ Në vitin 2025 janë parashikuar të rigrupohen/rishpërndahen 50 kontenierë të rinj për raste riparimi, meqë numri i nevojshëm i përlogarit me formulë është 285 kontenier.
- ✓ Nga viti 2026-2029, bashkia do të sigurojë 350 kontenier dhe do të bëjë shpërndarjen e nevojshme të kontenierëve që sipas llogaritjeve të bëra dhe gjenerimit të mbetjeve me shtimin e frekuencës së shërbimit, mbulon 100% të NJA duke krijuar një fond rezervë për riparime me 20-kontenier.

Nr	Emertimi Zones	Frekuenca mbledhjes dite /jave	Gjenerimi (kg/dit)	Gjenerimi (ton/dit)	Kapaciteti i kontenierit	Koeficienti mbushjes	Nevoja Kazane kontenier
1	Zona 1 Urbane	7	7100	7.1	1.1	85%	87
2	Zona 2 Rurale	2	1600	1.6	1.1	85%	88
3	Zona 3 Rurale	2	1600	1.6	1.1	85%	83

	Totali						275
--	--------	--	--	--	--	--	-----

Tabela 36: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

Pra për mbledhjen miks të mbetjeve sipas frekuencave të propozuara, bashkia duhet të shpërndajë në vitin 2025 në territorin e saj 285 kontenierë në pikat e përcaktuara. Nga 245 kontenierë që janë aktualisht, duhen shtuar 40 kontenierë të rinj, kryesisht nëpër njësitë administrative ku shërbimi nuk ofrohej më parë.

Ne tabelë tregohet edhe shpërndarja e kontenierëve nga viti 2025 deri në vitin 2029:

Numri i kontenierëve sipas zonave/numrit/viteve	Numri aktual gjendje	Parashikimi kontinerëve 2025-2029				
	viti					
	2025	2026	2027	2028	2029	
Zona 1	103	103	103	103	103	
Zona 2	88	93	98	100	100	
Zona 3	83	88	95	98	98	
Mirembajte/rezerve	10	10	10	10	10	
Total	285	294	306	311	311	
Kontenierë shtesë për çdo vit	10	10	10	10	10	

Tabela 37: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

Për efekt të amortizimit të kontenierëve, në këtë numër shtesë janë parashikuar dhe 10 kontenierë, të cilët do të përdoren në rastet e amortizimit të kontenierëve që aktualisht janë në përdorim.

Mbi organizimin e pikave të vendosjes së kontenierëve

Përcaktimi i pikave për vendosjen e kontenierëve do të jetë në funksion të grumbullimit miks të mbetjeve dhe në çdo pikë do të vendosen 1-2 kontenierë.

Objektivat

a) Objektivat për rezultatet

- Mbulimi 100% i familjeve, bizneseve, institucioneve me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve (nga 72% e familjeve, 100% e bizneseve dhe 100% e institucioneve që përfitonin shërbim në vitin 2024 do të përfitojnë 100% e tyre në vitin 2025 e në vazhdim).

- Rritja me 100% e plotësimit të të gjithë teritorit të Bashkisë me kontenierët e nevojshëm (nga 245 në vitin 2024 në 263 në të gjitha NjA).

b) Objektivat për produktet

- 36.360 banorë të bashkisë përfitojnë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve nga 32 137 banorë në vitin 2024.

Llogaritja e qendrave të kosto për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2025.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet të vitit 2024, u përdor si referencë për llogaritjen e kosto operative në vitet 2025-2029, me disa korigjime të rastit, të cilat ulën koston që në vitin e dytë të planit, 2025-2029.

Aktiviteti i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve sipas skemës së mësipërme përfshin:

- Grumbullimin miks të mbetjeve urbane në të gjitha pikat publike me kontenierë
- Pastrimin e vendit rreth kontenierëve
- Transportin e mbetjeve në incineratorin e Elbasanit.

Standarti i shërbimit

Bashkia do të largojë mbetjet çdo ditë për të gjithë zonën urbane, 2 herë në javë në zonën 2 gjysëm urbane, dhe 2-herë në javë për zonat rurale e zonat e mbrojtura. Pra, këto frekuenca rezultojnë si më të përshtatshme për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve. Për më tepër konsumatorët e shërbimit janë më të familjarizuar me këto frekuenca shërbimesh.

Nga shërbimi i pastrimit në Bashki, planifikohet se do të largohen të gjitha mbetjet e gjeneruara e grumbulluara në kontenierët sipas këtij grafiku:

1. Zona I-rë urban do t'i largojnë mbetjet 7-ditë në javë,
2. Zona II-të do t'i largojnë nga 2 herë në javë,
3. Zona III-të do t'i largojnë 2-herë në javë,

C. Kostot e Mbledhjes dhe Transportit të Mbetjeve

C.1 Kostot Kapitale

Bashkia ka të domosdoshme të krijojë infrastrukturën bazë fizike të menaxhimit të mbetjeve. Si hap i parë, duhet llogaritur sa kamionë dhe konteniere nevojiten për të menaxhuar mbetjet në mënyrën e duhur. Blerja e këtyre mjeteve përfaqëson investimin kapital. Përdorimi i numrit të popullsisë së regjistrit Civil të korigjuar ofron koston më të ulët kapitale.

C.1.1 Kosto kapitale për Kamionët

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 3 dhe 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë e njësisë. Normalisht në zonë rurale dhe gjysëm urbane mirë është të përdoret kamioni me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamioni me kapacitet 10 ton. Bashkia Librazhd ka synum që shërbimin e transportit ta realizojë me kamion me kapacitet 10 ton, i cili mbulon edhe sasinë e gjenerimit të mbetjeve sipas frekuncave të shërbimit në 3 zonat e mbulimit. Kosto e mirëmbajtjes gjatë 5-viteve paraqitet në tabelen e mëposhtme:

Kosto e mirembajtjes	Njesia	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Sigurimi i kamionit + taksat	Leke/kamion /vit	384.858	384.858	584.858	584.858	584.858
Vaj + filtra	Leke/kamion /vit	200.000	200.000	250.000	250.000	250.000
Goma	Leke/kamion /vit	144.000	144.000	144.000	144.000	144.000
Mirembajtja mekanike	Leke/kamion /vit	28000	28.000	70.000	70.000	70.000
Parkim	Leke/kamion /vit	-	-	-	-	-
Total		756.858	756.858	1.048.858	1.048.858	1.048.858

Tabela 38. Parashikimi i mirembajtjes kamionit në 5 vitet e ardhshme


C.1.2 Kosto kapitale për Kontenierët

Një kontenier tipik ka një vëllim 1.1m^3 , i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/m^3 për mbetjet. Kjo dendësi matet nga bashkia nëpërmjet peshimit, mbasi është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve. Kapaciteti i një kontenieri është në varësi të madhësisë së tij dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kontenier. Shifrat e dhëna mund të përdoren si vlerësim paraprak.

Numri i konteniereve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një tipologji të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Sipas grafikut numri i kontenierëve të nevojshëm për grumbullimin e mbetjeve është 457 .

Grafikisht, paraqitet:



Grafiku 5: Numri i kontenjerëve sipas viteve 2025-2029

Në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve në vite, bashkia do të plotësojë dhe numrin e nevojshëm të kontenierëve për vitet 2024-2029 nga fondi gjendje i tyre prej 275 kontenierëve. Pra, kontenierët në vitin 2029 rriten/rrishperndahen me 278 copë krahasuar me vitin 2024.

C.2 Kostot Operative

Kostot operative janë shpenzimet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kontenierët) dhe me transportin e mbetjeve, duke përfshirë koston e personelit. Këto kosto vjetore duhen mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.

Llogaritja e koston operative varet nga disa variabla:

- i. Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi, të cilat lidhen ngushtë me:
 - frekuencën e grumbullimit të mbetjeve (nga 1 herë apo 7 herë në javë), pra me sasinë e mbetjeve që grumbullohen. Nëse ka një gjenerim mbetjesh prej rreth 3.5 ton/ditë, ka nevojë për shërbime të përditshme, ndërsa për një gjenerim më pak se 3 ton/ditë organizohet grumbullimi një herë në 2 ose 3 ditë. Në rast se shërbimi nuk kryhet çdo ditë ka nevojë për shtim të numrit të kontenierëve.
- ii. Kostoja e karburantit- Konsumi i karburantit varet nga një planifikim i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient, gjedjes teknike të automjetit (*niveli i lartë i amortizimit sjell rritje të konsumit të karburantit në normativën për litra/km, sikurse edhe rasti i kamionit në pronësi të Bashkisë që ka normativ të lartë=40 litër/km*) dhe ndikon shumë në koston e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet gjatë viteve të planit të çmimit të karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

C.2.1 Kostot e Mirëmbajtjes

i. Mirëmbajtja e kamionëve

Kostot që lidhen me kamionët janë të larta dhe mirëmbajtja e tyre është kërkesë e legjislacionit. Mirëmbajtja e kamionëve është e lidhur me ndërrimin vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe kërkon një plan të mirë administrativ për mirëmbajtjen. Për më tepër, kostot e sigurimeve dhe taksave duhet të llogariten çdo vit.

Shifrat për sigurimet dhe taksat i referohen taksave kombëtare për tipin e kamionit të përdorur. Për shkak të ndarjes të bashkisë në 3-zona mbetjesh, kostot e mirëmbajtjes së kamionit 10 e 5 ton, që i shërben të gjithë bashkisë, janë përllogaritur në zonën e parë dhe të dytë të mbetjeve, por nëse Bashkia do të bëjë një përllogaritje të detajuar dhe analitike për çdo zonë shërbimi, ajo duhet të shpërndahet në mënyrë proporcionale në të 3-zonat, sipas kilometrave dhe frekuencës së mbledhjes e largimit për në landfill.

ii. Mirëmbajtja mekanike (shërbimet)

Mirëmbajtja mekanike lidhet me orët e punës së kamionit, me kushtet e rrugëve, përdorimin e kamionit. Këto kosto duhet të mbikqyren për t'i mbajtur sa të jetë e mundur në nivele të ulta. Sasia e parave të kërkuar për mirëmbajtjen vjen nga përvoja e mëparëshme e kamionit në pronësi/përdorim, nga gjendja teknike e kamionit të ri që do merret dhe nga përdorimi i këtyre mjeteve me një skenar/grafik të ri sa më eficient dhe i realizueshëm.

iii. Parkimi

Sugjerohet të përdoret për parkim të mjeteve toka e vet bashkisë, se në rast të kundërt mund të ketë kosto të tjera që lidhen me qeranë, me mirëmbajtjen e parkimit, rojet, shpenzime të tjera etj. Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJQV ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjithë mjetet.

Tabela më poshtë tregon kostot totale të mirëmbajtjes¹⁰ për çdo zonë mbetjesh, e llogaritur vetëm për 1-kamion dhe e ndarë vetëm në një zonë shërbimi:

KOSTOT E MIREMBAJTJES	Njësia	Zona I
Sigurimi i kamionit + taksat	leke/kamion/vit	584,858
Vaj + filtra	leke/kamion/vit	250,000
Goma	leke/kamion/vit	144,000
Mirëmbajtja mekanike	leke/kamion/vit	70,000

¹⁰ Kostot e mirembajtjes jane llogaritur per 2 kamione dhe jane ndare ne menyre te barabarte per zonat.

Parkim	leke/kamion/vit	-
Kostot totale të mirëmbajtjes	leke/kamion/vit	1,048,858

Tabela 39: Kosto e mirëmbajtjes

C.2.2 Kostot e Mbledhjes dhe Transportit

Kostoja e mbledhjes dhe transportit varet nga:

- i. **Koha e shpenzuar (orë)** - ka të bëjë me kohën për mbledhjen e mbetjeve në kohë për transportin e tyre në landfill. Kjo shifër varet nga lloji i automjetit dhe llojit të zonës (urban, gjysëm urban, rural). Zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 10t do t'i duhen 4 orë (keto mund të maten nga vetë bashkia).
Koha gjithashtu ndryshon në varësi të distancës në landfill dhe shpejtësisë të kamionit. Në landfill, kamionët kanë nevojë për një kohë shtesë për të shkarkuar që është mesatarisht 0,3 orë/turn.
- ii. **Distancat e përgjithshme (km)** - llogaritur si distanca për grumbullimin e mbetjeve dhe distanca në landfill. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të zvogëluar distancat e përgjithshme, pra, më pak kohë dhe më pak karburant. Itinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.
- iii. **Konsumi i karburantit (l)** - Varet nga lloji i automjetit dhe numri i shërbimeve. Nga përvoja konsumi për kamionë për grumbullimin e mbetjeve është përkatësisht: për kamionin 5t = 3 litra/orë, për atë 10t = 5litra/orë Nga përvoja mjete i përdorur harxhon 30 litra karburant për 100 km rrugë..
 - Konsumi për kamionë gjatë transportit është konsideruar përkatësisht: për llojin 5t = 0.4 litra/km, për llojin 10t = 0.5litra/km.
Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), këshillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në 'landfill').
 - Koha e shpenzuar – ka të bëjë me kohën për mbledhjen e mbetjeve dhe transportin e tyre në incinerator. Kjo shifër varet nga koha e harxhuar për mbledhjen e mbetjeve, zakonisht koha për mbledhjen e mbetjeve në zonën urbane është 6.6 orë në ditë, nga ora 24 deri në orën 6 të mëngjesit.
 - Distancat e përgjithshme (km) – janë distancat për grumbullimin e mbetjeve në qytet dhe zonat rurale, itinerari që përshkon kamioni. Është e rëndësishme të studiohet mirë itinerari që duhet të përshkrojë kamioni, për të harxhuar më pak kohë dhe karburant. Gjithashtu këtu kemi të bëjmë dhe me distancën nga pika transit për në incinerator.

Kostoja e mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve urbane për vitet e planit është llogaritur e ndarë për çdo zonë shërbimi. Kështu, kemi nëntë nën-zona ku do ofrohet shërbimi i pastrimit.

Ndarja është bërë nisur nga internerari që do të përshkrojë makina për mbledhjen e mbetjeve urbane. Gjithashtu frekuenca e pastrimit ndryshon nga zona në zonë.

C.2.2/a Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e grumbullimit të mbetjeve:

Kostot e grumbullimit	Zona I	Zona II	Zona III
Koha për të ngarkuar një kamion në herë - koha e grumbullimit [h]	5,0	8,0	8,0
Koha totale për grumbullim (nr. kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve) [h/ditë]	5	8	8
Koha për të shkarkuar në "landfill" [h]	0,3	0,3	0,3
Proporcioni i kohës totale për grumbullim [%]	77%	85%	85%
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit [L/vit]	37,1	24,9	24,9
Karburant total i konsumuar për grumbullim [L/vit]	13.504,4	7.768,8	7.768,8
Kostot totale për grumbullim [vit]	2.363.270 Lek	1.359.540 Lek	1.359.540 Lek

Tabela 40. Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Kështu, në zonën e qytetit, ku shërbimi do të ofrohet cdo ditë, është llogaritur një kosto deri në 2 363 270 lekë në vit. Në zonat e tjera, kjo kosto varion nisur dhe nga kilometrat që do të përshkrojë makina për mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve urbane dhe kostoja e vitit të parë të planit është llogaritur 2 719 080 lekë.

C.2.2/b Kosto e transportit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e transportit të mbetjeve:

Kostot e transportit	Zona I	Zona II	Zona III
Shpejtësia e lëvizjes [km/h]	60,0	60,0	60,0
Koha e transportimit për në "landfill" [h]	1,2	1,2	1,2
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	1,5	1,5	1,5
Proporcioni i kohës totale për transport [%]	23%	15%	15%
Totali i km për transport për ditë, të gjithë kamionat [km/d]	70	70	70
Karburan i konsumuar gjatë transportit [L/d]	31,5	14,0	14,0
Totali i karburantit të konsumuar për transport [L/vit]	11466	4368	4368

Kostot totale për transport [vit]	2.006.550 Lek	764.400 Lek	764.400 Lek
--	----------------------	--------------------	--------------------

Tabela 41. Kosto e transportit të mbetjeve

Sikurse u përmend më lart, kostoja e mbledhjes dhe transportit llogarit dhe transportin e mbetjeve nga pika tranzit për në incinerator. Shpenzimet e paraqitura në tabelën e mësipërme janë llogaritur sipas zonave përkatëse të shërbimit, duke qënë se sasia e kilometrave apo internerari që do të përshkrojë kamioni ndryshon nga zona në zonë.

C.2.2/c Kosto e personelit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Llogaritja e koston së personelit është një komponent menaxhues i përgjegjshëm që duhet të adresojë edhe aspektet sociale.

Fokusohet tek kostot operative të personelit, por duke u kufizuar tek shoferët dhe operatorët e kamionëve. Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi, personeli i punësuar duhet të mbikqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve të bashkise, për të siguruar që ekipi punon me eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës, etj.)

Kjo kosto kushtëzohet nga:

i. Personeli (Numri)

Një kombinim i mirë është 1 shofer për makinë dhe dy operatorë gjatë grumbullimit të mbetjeve. Operatorët nuk është gjithmonë e nevojshme të shoqërojnë kamionin në venddepozitim. Numri i shoferëve dhe punëtorëve llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për/kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe javë për mbulimin me shërbim nga viti 2025-2029 në 3-zona shërbimi.

Personeli duhet mbështetur me uniforma, mjete për grumbullim, pastrues kimike etj.

ii. Orari i punës

Sipas kodit të punës 1 punëtor nuk mund të punojë më shumë se 48 orë në javë. Në rast të orareve të zgjatura mbi 8 orë, orët shtesë konsiderohen me pagesë, dhe nuk mund të punohet mbi 12 orë në ditë. Kur është e mundur, orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen. Duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët e totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë, ose, në qoftë se është vërtet e nevojshme, të pajtohet në punë më shumë personel.

Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e koston duhet të kryhet një shpërndarje mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.

- a) **Llogaritja jonë:** maksimumi 8 orë në ditë dhe 40 orë një javë - kohë të përfshira këtu për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin, takime etj.
- b) **Llogaritja jonë:** 7.3% e kohës e harxhuar me punët e mirëmbajtjes dhe 7.7% e kohës për ditë pushime

Paga - është llogaritur në bazë të Kodit të Punës duke respektuar pagën minimale dhe pjesën tjetër në varësi të punës dhe kapacitetit. Paga përfshin pagesën dhe për detyra të tjera. Në pagesën mujore ligjore përfshihen dhe kritere të tjera si puna natën apo dhe vjetërsia në punë si dhe taksat ndaj shtetit.

Tabela e mëposhtme llogarit koston e shoferave dhe operatorëve:

Kostot e shoferëve dhe operatorëve	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III
Ditët e punës në javë	dite/jave	7	7	7
Orët e punës në javë	ore/jave	40	40	40
Orët e punës në ditë	ore/dite	8	8	8
Mirëmbajtja (ne % ndaj kohës së punës)	%	7.30%	7.30%	7.30%
Pushimet	%	7.70%	7.70%	7.70%
Numri i shoferave bazuar në nevojën ditore (duke marrë në konsideratë kufizimet sipas turneve = nuk mund të ndërrohen shoferët në mes të turnit)				
Orët e punës për javë / shofer (pa mirëmbajtjen dhe fundjavat)	ore	33.9	33.9	33.9
Koha javore e nevojshme për mirëmbajtje	ore/jave	2.47	2.47	2.47
Koha javore e nevojshme për pushim fundjave	ore/jave	2.61	2.61	2.61
Orët e punës për javë / shofer (me mirëmbajtjen)	ore/jave	36.3	36.3	36.3
Numri total i shoferave të nevojshëm (duke konsideruar orët maksimale të punës në javë)	numri	1	1	1
Paga mujore e shoferave	leke/vit	40,000	40,000	40,000
Taksat (ne % ndaj pages)	%	0.00%	0.00%	0.00%
Kosto vjetore per shoferet	leke/vit	872,840	872,840	872,840
Numri i punonjesve/operatorëve per ekip (1 shofer X 2 operatorë)	numri	2	2	2
Ore e punes ne jave/operator (perfshijne mirembajtjen)	ore/jave	28.0	28.0	28.0
Koha e mbetur per detyra te tjera ne jave / operator	ore/jave	11.9	11.9	11.9
Paga mujore e punonjësve/operatorëve	leke/vit	156,000	156,000	156,000
Taksat (ne % ndaj pages)	%	0.48%	0.48%	0.48%
Kosto vjetore per operatorët	leke/vit	461,760	461,760	461,760

Tabela 42. Kosto e shoferëve dhe operatorëve

C.2.3 Kostot e Depozitimit të mbetjeve në landfill

Sipas legjislacionit për “mbetjet” çdo NJQV duhet t’i depozitojë mbetjet në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Kosto për depozitim mbetjesh është vendosur si tarifë hyrjeje dhe zakonisht paguhet për ton.

Kostot e depozitimit për momentin është zero si rrjedhojë e marrëveshjes që Bashkia e Librazhdit ka me kompaninë që menaxhon incineratorin e Elbasanit.

C.2.4 Kostot e Amortizimit

Në mënyrë që sistemi të mbahet në punë për një kohë të gjatë rëndësi ka llogaritja e kostove të nevojshme për riinvestim. Pra, konsiderimi i kostos së amortizimit është çështje e qëndrueshmërisë të sistemit dhe siguron një sistem funksional.

Llogaritja bazohet në legjislacionin shqiptar për amortizimin e pajisjeve, e cila parashikon një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe lidhen direkt me koston vjetore për amortizimin për kamionët dhe kontenierët. Kjo i shtohet sistemit si një përqindje për vitin, që praktikisht paraqet 6-15% të shumës totale të koston për kamionë dhe 2-6% të shumës totale të koston kontenierë në vit.

Kjo nuk lidhet detyrimisht me amortizimin e vërtetë. Përdorimi i papërshtatshëm mund të shkurtojë jetën e pajisjeve dhe për këtë arsye të ndikojë ndjeshëm në koston për mirëmbajtjen, investimet, dhe eficiencën e shërbimit (koha, karburanti). Për kontenieret kjo llogaritje është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të tyre. Tabela e perlllogaritjes së amortizimit për vitin 2025 paraqitet:

Kostot e amortizimit	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III	
Kamionë					
Amortizimi i kamionit në vit	%/vit	6%	6%	6%	
Kosto amortizimi për kamionet	leke/vit	210,000	72,000	72,000	354,000
Kazanë					
Amortizimi i kazanit në vit	%/vit	15%	15%	15%	
Kosto amortizimi konteniere	leke/vit	538,773	436,212	432,879	1,407,864
Totali i koston amortizimit	Leke/vit	748,773	508,212	504,879	1,761,864

Tabela 43: Kosto e amortizimit sipas 3 zonave të mbetjeve

A. Kostot Administrative dhe e Ardhura Neto

Kostot administrative mund të përfshijnë koston e nevojshme për rikuperimin e kostove dhe për fushatat e ndërgjegjësimit publik. Ajo mund të paraqitet e veçantë, ose të jetë pjesë e kostove të përgjithshme administrative. Ky vendim merret në bazë të kapaciteteve dhe nevojave të bashkisë. Përveç kësaj, duhen llogaritur të ardhurat neto, të cilat kërkohen për teknologji të reja, zgjerimin e shërbimit dhe çështje të tjera të paplanifikuara dhe të nevojshme. Shifra përcaktohet nga administratori vendor bazuar në kapacitetin financiar. Shifra është vendosur si përqindje e kostove totale.

Përvoja sugjeron se këto përqindje janë përkatësisht: 9% për kostot administrative dhe 4% të ardhura neto. Në rastin e skenarit të realizimit me operator shërbimi, në shpenzimet administrative për efekt përllogaritje të fondit të plotë për buxhet, dueht llogaritur 20% e kostos, si e barabartë me fondin e nevojshëm për të mbuluar TVSH.

B. PERMBLEDHESE E KOSTOS OPERATIVE DHE KAPITALE

E.1 Kosto e vitit 2020

Sipas peshës që zënë shpenzimet në strukturën e kostos 2025, nga të gjitha zërat e shpenzimeve janë grupuar për efekt të ndarjes sipas zërave buxhetorë, shpenzimet për personelin në mbledhjen, grumbullimin, transportin, fshirjen dhe larjen, dhe paraqiten në tabelën e grafikun e mëposhtëm:

Struktura e kostos se shërbimit te pasterimit	%	Leke ne vit
Mirëmbajtje	8%	1,140,000
Grumbullim	8%	5,082,350
Transport	8%	3,535,350
Personeli	50%	7,853,760
Amortizimi	4%	1,761,863
Investime	13%	15,285,757
Fshirje	6%	12,004,120
Larje	1%	1,834,640
TOTALI	100%	48,497,841

Tabela 45. Struktura e kostos së shërbimit:




Figura 15: Struktura e kostos operacionale 2025

Siç edhe evidentohet, shpenzimet për personelin zënë pjesën më të madhe, në 28% të kostos. Kjo shpjegohet me mënyren e realizimit të shërbimit, manuale, pa paisje, mjete e teknologji të reja që reduktojnë nevojën për fuqi punëtore e ulin numrin e madh të tyre. Gjithashtu, kjo ka lidhje me mundësitë e pakta financiare të bashkisë dhe nivelin ekonomik të komunitetit. Më pas kosto e transportit është me 22% të strukturës, e ndjekur nga kostot e tjera të shërbimit.

E.2 Kosto e viteve 2025-2029

Bazuar në normat për njësi të kostos së vitit 2025 dhe disa shtesave të tjera u llogarit dhe kosto për periudhën 2025-2029 me ndryshimet e mëposhtme:

- Në vitin 2025, vlera totale 34.324.192,00 lekë, në të cilën vijohet me 3-zona shërbimit.
- Në vitin 2026, vlera totale 34.324.192,00 lekë, në të cilën vijohet me 3-zona shërbimit
- Në vitin 2027, vlera totale 34.324.192,00 lekë, në të cilën vijohet me 3-zona shërbimit
- Në vitin 2028, vlera totale 34.324.192,00 lekë, në të cilën vijohet me 3-zona shërbimit
- Në vitin 2029, vlera totale 34.324.192,00 lekë, në të cilën vijohet me 3-zona shërbimi.

Kosto totale operacionale	Njesia	Totali 2025	Total 2026	Total 2027	Total 2028	Total 2029
---------------------------	--------	-------------	------------	------------	------------	------------

Mirembajtje	Leke/vit	1,140,000	1,140,000	1,140,000	1,140,000	1,140,000
Kosto totale investime	Njesia	15,285,757	15,285,757	15,285,757	15,285,757	15,285,757
Numri Konteniervë			-	-	-	-
Kontenier 209	cope/leke	35000	35000	35000	35000	35000
Kosto totale		3.591.818	3.591.818	3.591.818	3.591.818	3.591.818
Të ardhurat neto (ne % ndaj koston totale)	%		-	-	-	-
Totali i të ardhurave neto	Leke/vit	-	-	-	-	-
TOTAL KOSTO OPERACIONALE	Leke/vit	13,083,322	14,407,707	10,565,179	11,188,379	10,538,278
Kosto totale per fshirje	Leke/vit	12,004,120	12,004,120	12,004,120	12,004,120	12,004,120
Kosto totale per larje	Leke/vit	1,834,640	1,834,640	1,834,640	1,834,640	1,834,640
TOTALI I KOSTOS SHËRBIMIT TE PASTRIMIT	Leke/vit	34.324.192	34.324.192	34.324.192	34.324.192	34.324.192
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë)	Leke/ton	5,329	5,329	5,329	5,329	5,329
Kostot totale për banor mbetje në vit	Leke/banor/vit	730	730	730	730	730

Tabela 46: Kosto e totale e shërbimit

Nëse do analizonim strukturën e koston së shërbimit të pastrimit në 5-vite, do vërejmë se është ulur si rezultat i rillogaritjes/rishperndarjes dhe ekonomizimit te fondeve buxhetore, e cila sipas secilit lloj shërbimi paraqitet edhe grafikisht si më poshtë:

Nga viti 2029:

- Kosto totale ka një rënie me 3,895,044 lekë deri në vitin 2029 që vjen nga efektiviteti i planifikimit të koston së shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ka realizuar edhe investime.
- Shërbimi i fshirjes dhe i larjes, që nga viti 2025 nuk ka pësuar ndryshime.

VI.PERSPEKTIVA FINANCIARE

7.1. Çështja e financimit dhe strategjia e “mbulimit të koston”

Investimet kapitale

Sipas vlerësimit paraprak të prezantuar më lart, investimet kapitale duhet të rriten në mënyrë progresive në 5 vitet e ardhshme sipas nevojave për përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve. Investimet do të kërkojnë të mbulohen nga burimet financiare vendore (nga të ardhurat e vetë bashkisë) të kombinuara me programet e huaja të donatorëve që janë të pranishëm në rajon për pajisje dhe makineri, si dhe nga burimet kombëtare, nga donatorët e huaj dhe bankat e zhvillimit, sektori privat apo kombinimi i tyre për investimet e tjera.

Në planin e menaxhimit për këto 5-vite është planifikuar përdorimi i një fondi prej 8.340 mijë lekë, të shpërnadarë sipas viteve si më poshtë vijon:

Kosto totale investime	Njesia	2025	2026	2027	2028	2029
Kamione	Lek/vit	-	-	-	-	-
Kontener cope 278 x 35000	cope/leke	9,730,000	350,000	350,000	0	0
Kosto totale		9,730,000	350,000	350,000	0	0

Tabela 47: Kosto totale e investimeve në vite

Strategjia e mbulimit të koston dhe niveli i tarifave

Sipas legjislacionit ekzistues, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në principet e mëposhtme:

- Parimin “kush ndot paguan”
- Rakordimin me buxhetin vjetor
- Prioritetet lokale dhe politike
- Mundësia e pagesës

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të manaxhimit të mbetjeve në Bashki tregon se ajo ka një performancë të mirë në realizimin e të ardhurave nga mbetjet duke mbuluar deri 91% të shpenzimeve aktuale për shërbimet e pastrimit dhe largimit të mbetjeve.

Gjithashtu vihet re dhe një planifikim me rezerva i të ardhurave. Në vitin 2018 të ardhurat vendore realizohen mbi 90%, ndërkohë që në këtë vit, baza e tatueshme për tarifën e pastrimit është rritur. Baza e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit aktual të tarifave dhe të të ardhurave nga mbetjet duhet të mbështet në parimin “ndotësi paguan” apo mbi “përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve” si dhe në elasticitetin e sistemit në mbështetje të iniciativave për minimizimin e

mbetjeve. Qëllimi i bashkisë është të zbatojë sistemin e mbulimit të kostos që lidhet me objektivat e saj.

Prandaj, nëse bashkia synon të përmbushë objektivin, **plani rekomandon:**

- 1- **ritjen e nivelit të realizimit të të ardhurave nga tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes si dhe duke përdorur nivelin e realizimit të të ardhurave si indikator matës.**
- 2- **realizimin e njoftimit për të gjithë tatimpaguesit për detyrimin e tyre vjetor.**
- 3- **monitorimin e marrëveshjes me Ndërmarrjen e Ujësjellësit si agjent për mbledhjen e tirifave,**

Ngritja e strategjisë për mbulimin e kostos fillon nga llogaritja totale e kostos, ku të gjitha kostot që lidhen me komponentët e sistemit të administrimit të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme evidentohen dhe përmbledhen në tabelën e mëposhtme, ku si vlerë referuese e të ardhurave janë vlera e planifikimit të tyre.

PLANIFIKIMI 5-VJECARE I MENAXHMIT TE MBETJEVE 2025-2029

Kosto totale e menaxhmit te mbetjeve	2025	2026	2027	2028	2029
Kosto Mbledhje largim mbetjesh Qyteti	8,612,773.00	8,612,773.00	8,612,773.00	8,612,773.00	8,612,773.00
Kosto Mbledhje largim mbetjesh Zonat ruarale	11,474,123.00	11,474,123.00	11,474,123.00	11,474,123.00	11,474,123.00
Kosto Dezifektim larje kontinieresh	399.900,00	399.900,00	399.900,00	399.900,00	399.900,00
Kosto Fshirje rrugesh	8.772.410,00	8.772.410,00	8.772.410,00	8.772.410,00	8.772.410,00
Kosto Fshirje rrugesh me Makine	2.675.450,00	2.675.450,00	2.675.450,00	2.675.450,00	2.675.450,00
Kosto Lagje rrugesh	1.834.640,00	1.834.640,00	1.834.640,00	1.834.640,00	1.834.640,00
TOTALI	40,523,155.20	40,523,155.20	40,523,155.20	40,523,155.20	40,523,155.20
Koficienti i ritjes buxhetit					
Te ardhura					
Mbulimi Kostos %					

Tabela 48 Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2025-2029¹¹

Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve

Mbledhja e mbetjeve urbane, pastrimi i rrugëve, etj, konsiderohen shërbime publike në shërbim të të gjithë qytetit nga i cili është e vështirë të përjashtojmë pa krijuar probleme urbane, mjedisore, por njëkohësisht është një shërbim me kosto të konsiderueshme për të cilën të gjithë që përfitojnë duhet të paguajnë.

Për të mundur një parashikim dhe strategji reale të llogaritjes së të ardhurave për periudhën 5-vjeçare, rekomandohet që bashkia të marrë në konsideratë faktorë të tjerë socialë¹² (si psh. pamundësia e disa familjeve për të paguar), apo eksperiencia dhe performanca aktuale e bashkisë

¹¹ Skenari i grumbullimit dhe transportit miks të mbetjeve dhe përdorimi i venddepozitimit të Majkoshit deri në vitin 2029.

¹² Në fakt sot bashkia aplikon një tarifë të reduktuar për familjet me ndihmë ekonomike


për të mbledhur të ardhurat që lidhet me rritjen nga niveli aktual i tarifës dhe të pagesës së tarifave nga konsumatorët si dhe performancën aktuale të bashkisë për mbledhjen e të ardhurave. Identifikimi dhe vlerësimi i këtyre faktorëve ndihmojnë bashkinë të orientojë veprimet dhe strategjitë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të mbetjeve. Tabela e mëposhtme paraqet se si janë marrë në konsideratë dhe kanë ndryshuar këta faktorë shoqërorë, si dhe performancën e bashkisë në vjeljen e tarifave dhe në parashikimin e të ardhurave për vitet e ardhshme.

Ndryshimi dhe rritja e të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga viti 2019 në vitin 2024, paraqitet si rezultat:

- ✓ i zgjerimit të zonave të shërbimit në të gjithë Bashkinë, e përrjedhojë rritje e bazës së tatueshme për familjarët nga 7739 familje në vitin 2025, në 8093 familje në vitin 2026, e pasqyruar në rritjen e vlerës në planifikimin e të ardhurave nga kjo tarifë me 132 mijë lekë.
- ✓ i rritjes së nivelit të tarifës në mënyrë graduale e periodike, në tatimpaguest e grupit Biznese, duke rritur vlerën e planifikimit të këtij grupi me 286 mijë lekë më shumë se në vitin 2026.

Për pasqyrimin e tendencës së mbulimit të kostos nga tarifa e pastrimit, duke e pasqyruar në nivelin e planifikimit të tyre, skenari del shumë optimist. Por, duke ndjekur ecurinë e realizimit ndër vite të kësaj tarife (viti aktual në 34%) përsëri mbetet shumë punë nga zyra përgjegjëse për të ardhurat në Bashki për realizimin në 100% të tyre.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet struktura e të ardhurave sipas tabelës përmbledhëse të 5-viteve të Planit menaxhimit.



Grafiku 7: Pesha specifike e tarifës së pastrimit 2025-2029

Të dhëna analitike mbi përlogaritjen e tarifës së pastrimit, sipas bazës së tatueshme, normës tatimore dhe vlerës për çdo grupim tarifor për vitet 2025-2029, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

projekte , zbatime, konsulence															
Për subjektet e biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit, ne zonen pedonale	5	220,000	1,100	5	220,000	1,100	5	220,000	1,100	5	220,000	1,100	5	220,000	1,100
	5	55,000	275	5	55,000	275	5	55,000	275	5	55,000	275	5	55,000	275
Per biznesin e madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit, jashte pedonales .	12	88,000	1,056	12	88,000	1,056	12	88,000	1,056	13	88,000	1,144	13	88,000	1,144
Per subjektet te biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit si bankat .	10	55,000	550	10	55,000	550	10	55,000	550	10	55,000	550	10	55,000	550
Per cdo subjektet e biznesit te madh i regjistruar ne regjistrin e biznesit si : fondacionet.	4	110,000	440	4	110,000	440	4	110,000	440	4	110,000	440	4	110,000	440
Për cdo njesi shitje te biznesit te madh ,ushqimore	44	88,000	3,872	45	88,000	3,960	47	88,000	4,136	48	88,000	4,224	48	88,000	4,224
bar – restorant , baste sportive , hotele , motele bujtina .	11	165,000	1,815	11	165,000	1,815	11	165,000	1,815	11	165,000	1,815	11	165,000	1,815
Për cdo subjekt i profesioneve te lira, farmaci , te biznesit te madh.	4	44,000	176	4	44,000	176	5	44,000	220	7	44,000	308	7	44,000	308
Për cdo subjekt i te biznesit te madh ne fushen e	4	33,000	132	4	33,000	132	4	33,000	132	4	33,000	132	4	33,000	132

ndertimit															
Për cdo njësi shitje të biznesit të madh materiale ndertimi,	4	27,500	110	4	27,500	110	4	27,500	110	4	27,500	110	4	27,500	110
shitje lende drusore, industriale , kablllore , internet.	6	110,000	660	6	110,000	660	7	110,000	770	7	110,000	770	7	110,000	770
Për cdo njësi prodhimi të biznesit të madh, fasonet .	1	88,000	88	1	88,000	88	1	88,000	88	1	88,000	88	1	88,000	88
Për cdo firmë ndertimi për seline administrative Bashkia Librazhd	22	55,000	1,210	22	55,000	1,210	22	55,000	1,210	22	55,000	1,210	22	55,000	1,210
Për subjektet e transportit mallit të biznesit të madh.	5	8,000	40	5	8,000	40	5	8,000	40	5	8,000	40	5	8,000	40
Për subjektet e transportit të udhëtareve të biznesit të madh.	15	2,000	30	15	2,000	30	15	2,000	30	15	2,000	30	15	2,000	30
Për cdo njësi shitje karburanti dhe gazit të lenget të biznesit të madh në rrugën nacionale	2,000	1,500	3,000	2,000	1,500	3,000	2,000	1,500	3,000	2,000	1,500	3,000	2,000	1,500	3,000
Për cdo njësi shitje karburanti dhe gazit të lenget të biznesit të madh jashtë rrugës nacionale	1,500	500	750	2,000	500	1000	2,100	500	1,050	2,300	500	1,150	2,500	500	1,250
Për ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore, Për ndërmarrjet dhe institucionet	627	600	376	627	600	376	627	600	376	627	600	376	627	600	376

jo shtetërore që kryejnë shërbime dhe realizojnë të ardhura	1,500	200	500	1,500	200	500	1,500	200	500	1,500	200	500	1,500	200	500
Për OJF dhe shoqatat	431		2,834	440		2,886	450		2,922	457		2,983	460		2,988
Për ambulantët	30	11,000	330	30	11,000	330	30	11,000	330	30	11,000	330	30	11,000	330
Pastrimi, largim mbeturinash (familjarët) Qytet	229		2,556	239		2,666	250		2,750	255		2,805	270		2,970
Pastrimi, largim mbeturinash (familjarët) në 6 njesite administrative	1	440,000	440	1	440,000	440	1	440,000	440	1	440,000	440	1	440,000	440
Pastrimi, largim mbeturinash, për familjet me ndihmë ekonomike,	3	220,000	660	3	220,000	660	3	220,000	660	3	220,000	660	3	220,000	660
TOTALI A+B+C+D 2025-2029			23,000			23,500			24,000			24,480			24,970

Tabela 49: Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave

VII.KUADRI LIGJOR DHE INSTUTUCIONAL

7.1 RREGULLORJA VENDORE

Në plotësim të kuadrit ligjor të administrimit të mbetjeve, Bashkia Librazhd duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren e vet lokale, ku të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, për të siguruar administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të vet administrativ.

Ky dokument duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve dhe pastrimin e qytetit duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Rregullorja duhet të jetë në përputhje me pjesën më të madhe të Direktivave të BE për Mbetjet dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Qëllimi i rregullores është mbajtja pastër dhe siguri i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e bashkisë.

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja do të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

a) *Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;*

b) *Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve, si:*

- Të mos dëmtohen kontenierët, të mos ndryshohet destinacionit i tyre, të mos dëmtohet dhe ndryshohet destinacionit i pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të mos depozitohen mbetjet, të mos digjen mbetjet në kazanë, të mos hidhen mbetjet në rrymat ujore dhe kanalizimet, të mos hidhen mbetjet në territore publike;
- Të shmangët dhe parandalohet hedhja abuzive e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, të mos depozitohen kafshët e ngordhura dhe materialet helmuese;
- Të shmangët parkimi i automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të pastrohet hapësira rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorë të shitjes; të mbahet higjienë dhe të dezinfektohen kontenierët dhe koshat e hedhurinave;
- Të paguhet taksat dhe tarifat vendore për mbetjet

c)Të drejtat dhe detyrimet e administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve) si:

- Proçedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave për mbetjet;
- Parandalimi i problemeve për shëndetin publik;
- Çështje të tjera të shëndetit publik, të tilla si procedurat e shëndetit, sigurisë dhe urgjencës;

Synimi i rregullores duhet të përfshijë të gjitha organizatat qendrore e lokale me seli në territorin e bashkisë, të gjithë individët, të gjithë operatorët socio-ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë territor, si edhe të gjithë operatorët publikë e privatë, vendas e të huaj të angazhuar në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve urbane (grumbullimi, depozitimi, transportimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe asgjësimi).

Rregullorja duhet të përfshijë edhe një seksion për marrëdhëniet me publikun, aktivitetet e ndaluara, sanksionet dhe masat ndëshkimore.

Një nga rregullat synuese më të rëndësishme që duhet përcaktuar në rregullore është kompostimi i mbetjeve bimore në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, si edhe ndalimi i përzierjes së tyre me mbetjet e urbane.

7.2 Detyrimi dhe Sanksionet.

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve duhet të parashikojë dhe sanksionojë një listë sa më gjithëpërfshirëse ndalimesh dhe detyrimesh. Në këtë listë mund të përfshihen ndalimet dhe detyrimet si më poshtë:

✚ është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin e bashkisë, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurta, gjysëm e ngurta, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensionit, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjt, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.

✚ është e ndaluar dorëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

✚ cili do shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryej largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;

- ✚ në rastet e shërbimit të grumbullimit “derë më derë” është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe/ose kontenierëve shtëpiak që kanë mbetje, përgjatë rrugës së grumbullimit, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia;
- ✚ është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- ✚ është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;
- ✚ është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensionimi, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t’i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;
- ✚ është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo pëmbysja,
- ✚ janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;
- ✚ është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);
- ✚ është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- ✚ është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;
- ✚ djegia e mbeturinave në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambjent tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.
- ✚ ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre.
- ✚ nuk pranohet e drejta për kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e bashkisë.

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve të shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksione që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan” ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijojë një sistem të drejtë dhe të shkurajojë dhe parandalojë ndotësit.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve lokale (Neni 61, 62 i Ligjit për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve), sipas rregullores së ardhshme të administrimit të mbetjeve dhe listës së gjobave dhe shkeljeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

7.3 Liçensimi Mjedisor

Një element i domosdoshëm i menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipëri, në të ardhmen, është përputhshmëria me ligjin. Legjislacioni Shqiptar mbi mbetjet vjen kryesisht nga Direktivat e Bashkimit Evropian – Kuadri Udhëzues për mbetjet i vitit 2008 dhe direktiva të tjera të ndryshme përfshirë, në veçanti Direktivën e Landfilleve të vitit 1999.

Çështjet që duhen patur parasysh lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Librazhd përfshijnë (lista nuk është shteruese): Kontrollin e Ndikimeve Mjedisore të Menaxhimit të Mbetjeve, Planifikimin e Përdorimit të Tokës, Zhvillimin e Tregut të Riciklimit, etj.

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- (i) Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me ARM (Agjencia Rajonale e Mjedisit) kur japim miratime për aktivitete që ushtrojnë veprimtari apo projekte për administrimin e mbetjeve (Neni 25 i ligjit për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta)
- (ii) Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme)
- (iii) Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.
- (iv) Të shikohet mundësia për një mekanizëm kontrolli jo vetëm për shërbimin e pastrimit nga vetë Bashkia, por edhe nga të tretë (auditues të pavarur) apo dhe kur të bëhen vlerësime për ndonjë vendepozitim lokal, apo rehabilitim hotspoti.
- (v) Të stimulohen bizneset për t'u certifikuar me standartet e sistemeve të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 të cilat do të rrisin pjesëmarrjen e bizneseve në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

7.4 Pjesëmarrja e Sektorit Privat

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncension i impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve, duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Duke iu referuar eksperiencës ndërkombëtare dhe në disa raste kombëtare, ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, ku disa prej tyre mund të jenë:

- sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, atëherë dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve;
- i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.

Aktualisht bashkia e realizon pastrimin përmes kontratës me një kompani private. Firma e pastrimit mund të shihet dhe si partner në arritjen e objektivave të riciklimit. Pra mund t'u ngarkohet në kontratën e ardhshme dhe ky detyrim, duke qënë se bashkia vetë nuk mund ta realizojë këtë dhe ka nevojë për buxhet shtesë.

Duke dashur të arrijë përfitimet maksimale nga përfshirja e sektorit privat në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve, bashkia duhet të ketë në vëmendje rekomandimet e mëposhtme:

- Konkurrenca:** Duhet të sigurojë një konkurrencë të vërtetë mes kompanive të sektorit privat dhe madje, nëse është e mundur, midis kompanive private dhe ndërmarrjeve publike të komercializuara që operojnë në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- Kërkesa e llogarisë:** për të siguruar se kontrata funksionon: Me qëllim që kontrata me sektorin privat të japë përmirësimet e duhura dhe të matshme në efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimit, duhet të përmbushen një sërë kriteresh bazë:
 - Masat e mirë-përcaktuara të performancës;
 - Sanksione të zbatueshme për punën e dobët;
 - Monitorim vigjilent dhe
 - Kërkesa e llogarisë për kostot.
- Transparenca:** Marrëveshjet financiare dhe marrja e vendimeve duhet të jenë transparente. Arsyet për vendimet, veçanërisht për zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve nga sektori privat, si dhe administrimi i fondeve publike duhet të jenë të hapura për publikun;
- Kohëzgjatja e duhur e marrëveshjes dhe ofrimi i pajisjeve:** kontratat që përfshijnë edhe investime në makineri duhet të kenë të paktën një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, ndërsa investimet në prona të patundshme kërkojnë të paktën një kohëzgjatje prej 10 vjetësh për marrëveshjet dhe kontratat.

7.5 Mbështetja Politike

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve paraqet sfida reale për të gjitha palët e interesuara për të mbajtur një qasje të koordinuar të menaxhimit të tranzicionit drejt një sistemi modern të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Librazhd. Në këtë kuadër do të jetë thelbësor komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet palëve të interesuara dhe një mënyrë efektive për të vijuar progresin e zbatimit të PVMM.

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për banorët e bashkisë dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori ashtu si masat për përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe publikut. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit.

Bashkia në bashkëpunim me kompaninë e pastrimit duhet të përcaktojë dhe publikojë grafikun për pastrimin e qytetit (çdo ditë, herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje), dhe grafikun për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve (gjatë ditës).

Me ndryshimet administrative të territorit, vetëm një supervizore nuk e adreson dot gjithë elementët që kërkon të arrijë ky plan ambicioz për menaxhimin e mbetjeve urbane në 5 vitet e ardhshme. Ndaj rishikimi i strukturës duhet të jetë prioritet për bashkinë që të sigurojë një shërbim sa më cilësor. Kjo strukturë, që në rastin e progresit duhet të konceptohet të paktën si sektor për menaxhimin e mbetjeve brenda Agjencisë së shërbimeve Publike duhet të përmbajë në organikë të paktën një staf prej 2 personash (dy ekspertë të fushës). Objektivi kryesor i këtij sektori do të jetë:

- mbulimi me shërbim cilësor të të gjithë territorit,
- mbulimin 100% të kostos nga tarifa,
- rishikimin e kontratave të pastrimit dhe
- monitorimin e vazhdueshëm të PVMMU.

Pra nëse njëri ekspert do të merret me supervizimin dhe monitorimin e kontratës së shërbimit dhe tjetri duhet të merret me kosto tarifën (personalizimin e të dhënave, hedhjen e tyre në sistem, pregatitjen e faturës mbledhjen e saj brenda sektorit që edhe 100% e tariffës të shkojë për mbulimin e kostos).

Nga eksperiencat e aplikuara në disa bashki, përmes asistencës së dldp, mund të adoptohen përshkrimet e punës për të paktën supervizorin dhe një specialist tjetër (shtojca 1).

VIII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Nëse duam që PVMMU të funksionojë dhe zbatohet me sukses në Librazhd, është mjaft e rëndësishme që publiku ta kuptojë dhe mbështesë atë në çdo hallkë të tij. Po ashtu, suksesi i skemave që propozohen, nismave që do të ndërmerren varen tërësisht nga shkalla e angazhimit nga vetë përdoruesit si: familjarët, bizneset, etj.

Menaxhimi i mbetjeve është sa problem teknik dhe kërkon organizim të mirë dhe përdorim të teknologjive moderne, por është dhe problem komunikimi me zbatuesit e saj, qofshin këta banorë, biznese apo institucione publike. Ndërsa incentivat ligjore dhe ato ekonomike mund të ndryshojnë sjelljen e qytetarëve, krijimi i ndërgjegjes së duhur të publikut dhe dëshira për të menaxhuar sa më mirë mbetjet është po aq e rëndësishme.

Ndërsa në fillim të procesit zhvilluam anketimin me qytetarët vumë re se ata kishin shumë pak informacion në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, perceptim të ulët të përpjekjeve të bashkisë për të ndryshuar situatën dhe përgjigje të ulët në lidhje me pagimin e taksës.

Promovimi i ndërgjegjësimit publik mbi problemet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, dhe inkurajimi i individëve dhe komuniteteve për të marrë më tepër përgjegjësi për mbetjet që ata vetë prodhojnë, është një aspekt i rëndësishëm i informimit qytetar por edhe i mirë artikuluar nga vetë bashkia në Vizionin e PVMMU. Ndaj bashkia duhet të fokusohet në:

A. Informimin e publikut mbi shërbimin e ri të menaxhimit të mbetjeve – duke i mundësuar publikut të bashkëpunojë në mënyrë konstruktive me një skemë të re. Publiku duhet të njoftohet mbi vendet e përcaktuara si VGM, oraret e zbrazjes së kontenierëve, frekuencën e tërheqjes së mbetjeve, standartin e shërbimit të pastrimit. Informacioni duhet të komunikohet në mënyrë të qartë për t'i mundësuar ata të koordinohen me rregullat e shërbimit dhe t'u tregohen dhe mjetet që do të përdoren për mbledhjen e mendimeve dhe ankesave të tyre. Ky proces duhet të përfshijë gjithashtu edhe informacion mbi rregulloren, penalitetet dhe sanksionet, strategjinë e mbulimit të kostos dhe nivelin e tarifës, mbi mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

B. Rritja e ndërgjegjësimit ndaj praktikave të mira në menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane – duke nisur nga identifikimi i grupeve të interesit dhe hartimi së bashku me to i programeve për zbatimin e skemave të ndarjes në burim të mbetjeve, riciklimit, apo kompostimit. Në grupet e interesit duhet të përfshihen familjet, bizneset, institucionet, grupet në nevojë, të rinjtë dhe fëmijët si pjesë e grupeve të fokusuara të cilat do të përfitojnë nga shërbimi i pastrimit. Ata do të marrin një rol të rëndësishëm në promovimin, kryerjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit publik.

C. Edukimi i brezit të ri përmes një programi të detajuar edukues brenda dhe jashtë ambjenteve të shkollës për të rritur njohuritë e tyre mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe për të inkurajuar

minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin. Praktikë apo aksionet konkrete të pastrimit janë një metodë shumë e mirë edukimi duke bashkëpunuar me grupet rinore dhe me stafet pedagogjike të shkollave.

D. Forcimi dhe rritja e përfshirjes publike dhe biznesit – duke rritur bashkëpunimin me grupe të ndryshme interesi në sigurimin e mbështetjes publike për iniciativat e menaxhimit të mbetjeve, alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin, mobilizimin e publikut dhe grupeve të tjera të interesit në mbështetjen e zbatimit të tyre, futjen e pagesës së rregullt të tarifës duke vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë e tyre për të paguar. Një çështje e cila ka nevojë të merret në konsideratë, është siguri i angazhimit privat në menaxhimin e mbetjeve urbane, për të krijuar mundësi për krijimin e partneritetit publik-privat (PPP).

Metodat që mund të përdoren

Bashkia Librazhd duhet të diversifikojë sa më shumë mjetet e komunikimit që edhe qytetarët të kuptojnë sfidat dhe ecurinë e bashkisë në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe në të gjithë territorin. Drejtoritë përkatëse në bashki duhet të promovojnë sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve. Nga bashkia mund të shpërndahet falas një broshurë me orientime për përdorimin e kontenerëve dhe vendndodhjen e tyre, etj.

Metoda e komunikimit *derë më derë* rekomandohet si mjaft efektive për të ftuar qytetarët të bëhen pjesë e nismave të ndryshme, sic është ajo e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret por edhe të mbështesin bashkinë në zbatimin e skemave të përzgjedhura. Banorëve dhe bizneseve duhet t'u shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, etj.

Të përdoren kamionët dhe kontenerët për informim: Tek të gjithë kamionët dhe nëse është e mundur tek kontenerët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) parrulla “Mbani pastër qytetin tuaj” apo ndonjë parullë tjetër, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht. Këto detyrime duhen përcaktuar në kontratat e pastrimit.

Mekanizmat e marrjes së mendimit dhe reagimit qytetar – Autoritetet lokale kanë identifikuar ndërjegjen e ulët qytetare një nga faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në pastërtinë e qytetit dhe më konkretisht në papastërtinë e disa PGM, (hedhjen pa kriter të mbetjeve urbane dhe voluminoze jashte kontenerëve) si dhe ekzistencën e pikave informale ku hidhen pa kriter mbetje. Për këtë qëllim, ndërjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurt të mbetjeve.

Bashkia duhet që përmes njoftimeve publike të ftojë qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak edhe kur diskutohen çështje të menaxhimit të mbetjeve. Institucionalizimi i një mekanizmi të tillë do të rrisë besimin tek banorët se bashkia i merr parasysh mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre. Kjo realizohet duke ngritur zyrën e informacionit për të mundësuar marrjen e mendimit nëpërmjet:

- Mbledhjes së ankesave të qytetarëve.
- Sondazheve të herëpashershme si një mjet i mirë monitorimi të shërbimit dhe standarteve që ai ofron.

IX. Plani i Aktiviteteve

Vizioni: Prania e një mjedisi të pastër me shtrirje në gjithë teritorin e bashkisë dhe eliminimin e mbetjeve urbane që grumbullohen në basenin ujëmbledhës të Lumit Shkumbin.

Objektivi	Aktivitete	Rolet Përgjegjese	Aktorët mbështetës	Afatet Kohore	Buxheti
I. Deri ne vitin 2024 te kemi arritur shtrirjen e sherbimit te pastrimit deri ne 80% te popullsise	1.1 Prezantimi i PLMIM dhe konsultimi me publikun	Bashkia Librazhd	Grupi i punes PLMIM, Komuniteti Këshilli Bashkiak	Afatshkurtër	Pa kosto
	1.2 Rishikim dhe perditesim perfundimtar i PLMIM	Drejtoria e Shërbimeve Publike		Afatshkurtër	Pa kosto
	1.3 Miratimi i PVMMU	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkise Grupi i Punës i PVMMU	Afat shkurtër	Pa kosto
	1.4 Investimi në infrastrukturën e pastrimit (blerja e konteniere shtese ne zonat e reja ku do te shtohet sherbimi i pastrimit)	Bashkia Librazhd	Firma e pastrimit	Afat gjate	8,340,000
	1.5 Krijimi i një ekipi per zbatimin dhe monitorimin e PVMMU në gjithë territorin e Bashkisë.	Kryetari i Bashkisë	Grupi i Punes për PVMMU, Keshilli Bashkiak	Afatgjate pergjate gjithe viteve te planit	

	1.6 Shtrirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohej shërbimi I mbetjeve dhe konsolidimi I shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim të grumbullimit dhe largimit të mbetetjeve urbane	Supervizori i shërbimit të pastrimit, Firma e pastrimit	Kryetari Bashkisë,	Afat shkurtër, pas nënshkrimit të kontratës së re me operatorin fitues	Pa kosto
	1.7 Takime paraprake me komunitetin për shtrirjen e shërbimit	Firma e Pastrimit, Organizatat mjedisore, ADZM, Shërbimet mjedisore në Bashki	Supervizori i shërbimit të pastrimit	Afatshkurtër	Pa kosto
	1.8 Aprovimi i sanksioneve dhe penaltiteve për çështjet e mbetjeve	Drejtoria e Shërbimeve Publike Drejtoria Juridike	Drejtoria e menaxhimit financiar, Këshilli Bashkiak	Afatshkurtër	Pa kosto
2. Ndergjegjesimi i komunitetit për hedhjen e mbetjeve në venddepozitimet e caktuara, në vendet ku shërbimi ofrohet për herë të parë	2.1 Aktivitete ndergjegjesuese në komunitet dhe në shkollë, për mbrojtjen e mjedisit .	Firma e Pastrimit, Organizatat mjedisore, ADZM, Shërbimet mjedisore në Bashki	Supervizori i shërbimit të pastrimit	8 aktivitete në vit	100,000
	2.2 Ndërhyrje të vazhdueshme në shtratin e lumit për pastrimin e mbetjeve të akumuluar	Firma e pastrimit, Shërbimet mjedisore në Bashki	ADZM, Organizatat mjedisore, vullnetare në mbrojtje të mjedisit, nxënësit e shkollave	Aktivitete gjatë Dites së Tokës (22 prill) aktivitete gjatë Javës së Ndergjegjesimit për mbrojtjen e mjedisit, aktivitete në ditë të tjera ku ndërhyrja shihet e nevojshme	150,000

	2..3 Përgjatë Lumit Shkumbin dhe degëve të tij, pastrimi, rehabilitimi dhe sinjalistika e nevojshme në këto zona.	Sherbimet mjedisore ne bashki,	Firma e pastrimit , organizatat mjedisore	Afatshkurtër	2,000,000
	2.4 Informimi i komunitetit për tarifën dhe koston e shërbimit	Sherbimet mjedisore ne bashki,	Supervizori i shërbimit te pastrimit	Afatshkurtër	Pa kosto
	2.5 Organizimi i ditëve të pastrimit me pjesmarrjen e komunitetit.	Sherbimet mjedisore ne bashki,	Firma e pastrimit , organizatat mjedisore	Cdo vit/5 vjet	Pa kosto
3.Menaxhimi i mbetjeve urbane ne zonat turistike si parku kombetar Shebenik Jabllanice, Rezervati i gjuetise Kuturman dhe ne te gjitha monumentet e natyres deri ne vitin 2024.	3.1 Aktivitete ndërgjegjësuëse me banorët në zonat turistike për mbrojtjen e mjedisit	Sherbimet mjedisore ne bashki	ADZM, Organizatat mjedisore	Afatshkurtër , 4 aktivitete ne vit	60,000
	3.2 Mbulimi me kontenerë i zonave te mbrojtura	Supervizori i shërbimit te pastrimit, firma e pastrimit	Organizatat mjedisore	Afat shkurter, mbulimi me konteniere behet brenda vititi te pare te planit	990,000 Lekë
	3.3 Nisma kompostimi te shoqëruara me sensibilizim komuniteti	Sherbimet mjedisore ne bashki, ADZM	Organizatat mjedisore	Afatshkurtër ,	Pa kosto
4.Te ulet sasia e mbetjeve qe dergohen ne incinerator ne masen 20% krahasuar me vitin 2019	4.1 Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjesuëse ne shkolla dhe komunitet per ndarjen e mbetjeve qe mund te kompostohen dhe per parandalimin dhe minimizimin e plastikës	Sherbimet mjedisore ne bashki, ADZM	Organizatat mjedisore	Afatshkurtër , 6 aktivitete ne vit	50,000
	4.2 Projekte pilot për ndarjen e mbetjeve në burim dhe nxitjen e riciklimit (plastikë dhe letër/karton)	Sherbimet mjedisore, bizneset ricikluese ADZM	Organizatat Mjedisore Sherbimet mjedisore, bizneset ricikluese ADZM	Afat mesem, per nje periudhe disa mujore	1,000,000

5. Nxitja e bizneseve ricikluese neper favorizimeve me taksat vendore dhe mbeshtetje nepermjet formave te partneritetit publik privat	5.1 Takime me bizneset ricikluese, shpjegimi i skemes se perbashket per grumbullimin e mbetjeve te riciklueshme)	Sherbimet mjedisore ne bashki, ADZM,	Organizatrat mjedisore	Afatshkurtër , takimet te planifikohen gjate vitti te pare te planit, qe procesi tem und te filloje sa me shpejt	30,000 Lekë
	5.2 Hartimi dhe miratimi i nje pakete fiskale me kushte favorizuese per bizneset ricikluese	Sherbimet mjedisore ne bashki, specialistet e finances ne bashki, organizatat mjedisore	Keshilli bashkiak	Afatshkurtër	Pa kosto
	5.3 Transparenca dhe komunikimi: Procesi i caktimit tw tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet ti komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit nw masë si dhe atë “derë më derë”	Bashkia Librazhd	Drejtoria e Shwrbimeve Publike, OJF-të, Vullnetarë	Afatshkurtër	Pa kosto
	5.4 Aplikimi i penaliteteve të qarta efektive dhe procedurave detyruese për mospagimin e tarifave të mbetjeve	Bashkia Librazhd	Insp Mjedisit, Drejtoria e Finances	Afatshkurtër	Pa kosto

Tabela 50: Plani i Veprimit

X. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.

Është e rëndësishme të monitorohet progresi i PVMMU, efektiviteti i masave që janë marrë dhe të identifikohen nevojat e reja.

Në punën për zbatimin e PVMMU, Kryetari i Bashkisë dhe stafi i tij duhet të mbështeten nga komuniteti dhe aktorët e tjerë institucional.

Aktorët kryesor dhe marrëdhënia raportuese mes tyre në nivel vendor dhe kombëtar është:




Tabela 51: Marrëdhënia raportuese ne nivel vendor dhe kombëtar

Koordinator i përgjithshëm për zbatimin e monitorimit duhet të jetë Drejtoria e shërbimeve. Ekipi do të fillojë të punojë menjëherë. Njerëzit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të (i) kenë njohuritë e duhura në fushë për të realizuar monitorimin si dhe (ii) në numër të mjaftueshëm për të siguruar që janë matur të gjithë treguesit e monitorimit në të gjithë territorin, që janë përpunuar të dhënat dhe që në fund janë arritur konkluzionet. Ekipi i zbatimit duhet të siguroj informacion të saktë në lidhje me ecurinë e zbatimit të planit me të gjithë elementet e tij nëpërmjet:

- ☐ Organizimit të vizitave në terren gjatë orareve të punës sipas grafikut javor përgjatë gjithë vitit.
- ☐ Organizimit të takimeve të hapura me grupe qytetarësh.
- ☐ Monitorimit të dokumentacionit.

Detyra e parë e këtij ekipi do të jetë hartimi i planit të detajuar të monitorimit, i cili duhet të konsistojë në indikatorët e performancës që vijnë:

- Indikatorët e performancës mjedisore
- Indikatorët financiarë
- Indikatorët administrativ

Shkalla e hierarkisë:




Tabela 52: Skema e monitorimit të shërbimit të pastrimit

Grupi i punës në bazë të informacionit të mbledhur do të raportojë tek Kryetari i Bashkisë / Sekretari i Përgjithshëm mbi ecurinë e planit çdo vit.

Në të njëjtën kohë, të gjitha palët e interes në menaxhimin e mbetjeve, do t'u ofrohen informacione të rregullta mbi zbatimin e planit dhe fletë informative mbi gjendjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor.

Detyrat e ekipit monitorues

Bashkia (Agjencia e Shërbimeve Publike)

- Përcakton prioritetet, termit e tenderit, planin e menaxhimit të mbetjeve
- Përcakton strategjinë e komunikimit mbi grumbullimin e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve
- Përcakton buxhetet, miraton faturat, përfshirë gjobat
- Blen materiale të reja (kazanë) dhe hap tenderat e rinj, nëse është e nevojshme
- Përcjell shqetësimet e këshillit/kryetarit/qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar
- Negocion me ndërmarrjen/kompaninë në rast mosmarrëveshjes
- Raporton periodikisht (një herë në javë) tek kryetari i bashkisë

Administratori

- Kontrollon çdo ditë (vetë ose nëpërmjet inspektorëve) shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve dhe raporton tek drejtori i ndërmarrjes (një herë në muaj);
- Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimit;
- Verifikon dhe përshtat nevojat për kazanë:
 - Kur kazanët nuk mjaftojnë (kazanë të mbushur plot dhe mbetje në rrugë): propozon shtimin;
 - Propozon të zhvendosë / të heqë ose të shtojë pika grumbullimi
 - identifikon nevojat e veçanta: p.sh. mbetje inerte për t'u mbledhur,
- Jep informacion:
 - ndërmarrjes menjëherë për çdo mangësi në cilësi / sasi:
 - Kazanë të papastruar apo të dëmtuar rrugën, ditën dhe orën e vëzhgimit

Statistika të ofruara nga kompania

Kontraktuesi duhet të mbajë statistika ditore në pikat kryesore dhe t'i raportojë ato çdo muaj, në formë elektronike apo në letër, tek mbikqyesi.

- ✓ Sasinë ditore të mbetjeve të grumbulluara dhe të depozituara në venddepozitim
- ✓ Numrin e kazanëve të pastruar
- ✓ Orët e sakta të grumbullimit: kohën e saktë të nisjes së kamionëve, kohën e zbrasjes në venddepozitim dhe kohën e kthimit në garazh
- ✓ Kilometrat ditore të çdo kamioni
- ✓ Numrin ditor dhe itinerarin e lëvizjes së kamionëve
- ✓ Listën ditore të pastrimit dhe të larjes së rrugëve
- ✓ Oraret ditore të larjes dhe të fshirjes manuale/ mekanike

- ✓ Listën e punonjësve dhe oraret ditore të punës
- ✓ Inventarin mujor të kazanëve, nga rruga në rrugë dhe gjendjen fizike të tyre
- ✓ Zhvendosjen, mbajtjen ose humbjen e kazanëve: kazanët e larë: listën e kazanëve me probleme (rrugën, numrin e kazanit), riparimet specifike, datën etj.
- ✓ Sasinë e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluar/përpunuar nga qendra (t) e grumbullimit
- ✓ Marrjen e komenteve/reagim ndaj kërkesave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve ose supervizorit rreth mungesës së cilësisë apo të sasisë së grumbulluar